**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

**Nr.** 02-060/01-33896 **dt.** 13/07/ **2023**

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z.Milaim Hajdari, me dt. **20.07.2023** (e enjte) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Bordit të Komunës.

**THËRRET**
**Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa**

Mbledhja do të këtë:

## Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt.22.06.2023.
2. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri në Bashkësi.
3. Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Gllogovcit për vitin 2022.
4. Raporti Financiar Janar-Qershor 2023.
5. Propozim vendim për ndryshim-plotësimin e rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba.
6. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
7. Të ndryshme.

Drenas, 13.07.2023

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

02 Nr. 060/04 - 33894 dt. 13.07. 2023

**PROCESVERBALI**

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **22.06.2023**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë, Rend Dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 19.05.2023.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026, lista e projekteve kapitale 2024-2026 dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor.
3. Propozim vendim për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllogoc.
4. Propozim vendim për financimin e projektit nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale.
5. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-26071, dt.1.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes-kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro.
6. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-28069, dt.13.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes OU Nicrophthalma, në shumën totale prej 3,000.00 euro
7. Vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Zveçanit.
8. Vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. **Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 19.05.2023.**
Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: 2. **Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026, lista e projekteve kapitale 2024-2026 dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor**.

**Hamit Kastrati**- Përshëndetje për të gjithë të shikohet korniza afatmesme arsyeja mungesa e projekteve kapitale karshi nevojave nëpër fshatra, unë kërkoj që të shikohet edhe një herë korniza afatmesme për seancën e radhë, për ketë propozim unë jam kundër për momentin.

**Florentina Elezi Veliu**- unë i kam disa pytje specifike, pytja e parë Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Fehmi e Xheva Lladrovci" Drenas 700,000.00 € a janë ekstra këto 700,000.00 € apo i keni llogarit bashkë me ato të tjerat, pyetja e dytë me sa unë e di qeveria veq ka vendos dhe keni nënshkru për me ndertu QKMF ndërsa këtu nuk pashë buxhet askund që keni nda diqka për bashk financim? Pyetja tjeter është prap si qdo vit tjeter që kom kërku edhe prap po kërkoj që i keni i keni dy ose tri fshatra, që jan me një kod e kuptoj nuk keni nevoj mema sqaru se është më leht mos me ba disa kode buxhetore unë gjithmon kom kërku që me pas edhe një plan të brendshëm që sigurisht duhet me pas ju si komunë që ne me dit sakt sa metra kan me u shtru qoft asfalt qoft kanalizim qoftë ujësjellë,s dmth gjithqysh në seancën e radhës me pru edhe planin e brendshëm të komunës që secili fshat qka ka përfitu prej këti buxheti e jo kështu tri ose katër fshatra me një vend për shkak se është shumë hapsir për manipulim edhe shumë e paqart edhe për qytetarët po edhe për neve si asambleist me votu kur nuk e dim se qka e cili fshat qka po përfiton aty është e shkruar që për korniz buxhetore i keni jep prioritetet e qytetarëve po sa pashë këtu për ujësjellës i keni nda 200,000.00 sa mundet me përfshi ujësjellësi nëpër fshatrat që nuk është ujësjellësi me kët shumë qka mundemi me bo me to për mendimin tem jan pak edhe është dasht me I jep perparsi sidomos ujit në Drenas në përgjithësi, po për fshatra po mendoj që kët vit nuk duhet me votu asnjë buxhet ku nuk përfshihet ujësjellësi me qen I përfundun, u bo boll ma duke thën jo kët vit jo kët vit. Gjithashtu një propozim e kam po nëse doni e lëjm për muajin Shtator kur bëhet bugjeti po nëse doni tash po kisha thën që shumica e komunave tashmë veq e kan për me I subvencionu lehonat e secilës komunë me shumë të caktune kështu që mendoj që edhe kjo duhet me hi në ketë vit në buxhet.
Shtëpia për komunitetet për personat me aftësi të kufizune kisha dasht mema sqaru dikush pse nuk u kan e sqarune qysh e tek, edhe ndërtimi I shkollës "Rasim Kiqina" 25,000.00 €

edhe këtë nuk e kom kuptu hiq qfar ndërtimi nuk është që e keni përmend që ka me u ndërtu një shkoll e re edhe 25,000.00 € nuk është najfar shifre që mundet me u ndërtu diqka. Ndërtimi i rrugës bregut Qyqavices janë 5,000.00 € a e keni plan veq me shti projekte sa me than që kemi fillu po edhe me I lan në gjysmë apo e keni ndërmend me përfundu diqka në mandatin e juj, se 5,000.00 € euro jan shifer qesharake nuk besoj që muni me përfundu diqka ashtu 5,000.00 € euro ma mirë këto me I qu me një projekt që përfundohet se boll ma me projekte të lena në gjysmë, edhe nëse nuk ju marr kohë psh këndi I lojrave dhe rekreacion në shkolla nuk ceket në cilën shkollë, 40,000.00 euro po nuk ceket as në cilën shkollë as qka mendoj që edhe kjo për seanc duhet me na ardh në mënyr specifike se në cilën shkollë, dikund tjetër edhe është ndërtimi I lojrave nuk i keni specifiku shumë gjana që me pas më të qartë edhe na, është dikund edhe këndi I lojrave që nuk është I specifikum, në seancë pres prej juve me qenë më sqarues unë çdo vit e kom kërku ktë që me pas një project të brendshëm, një plan të brendshëm që me pa edhe ne po asnjëher se kemi pa tash ka ardh koha edhe unë me qen ma serioze me ju bë presion vazhdimisht nëse është nëvoja me pa qat planin e brendshëm edhe ju me qen pak ma serioz kur boj kërkesa të pakten me fillu me punu.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** – Hamit nuk të kuptova që the jam kundër kornizës afatmesme buxhetore, jemi në procedura të dëgjimeve buxhetore për me përcaktu qka ku dhe ku do të orientohemi me investu hiq se kuptova pytjen apsolut që mundesh me ma spjegu qka ke dashtë me thën unë isha ken mirnjohës. E dyta Florentina the a keni paraparë për QKMF me ministrin jemi dakordu ne i kemi pas 15% a 30% me participu Komuna edhe kur u kan u shpall tenderi para dy viteve e kemi anulu at tender me memorandum të ri sot e shpall ministria ne e kemi ba projektin, projektn po jav kujtoj edhe një her e kemi ba falas qe tri vjet katër vjet na e k aba Hamdi Qorri e falenderoj publikisht se veq sa aka vujt aj ka mujt me than më falni unë nuk jom pagu edhe me lan sepse dikush ka dasht me lan qu deri te qajo pikë për me mujt mos me e zhvillu si procedur me ndërtu QKMF-në pra bëhet me mjete të qeveris dhe krejt procedurat I zhvillon qeveria. krejt procedurat I kemi kryer 200,000.00 € janë të mjaftueshme për diçka që n a ka mbet pa e kry, pra është përgjegjse kompania me e lëshu ujt, me e kfjell ujin kur bjen shi mesi e permende edhe atë përgjigjen ta jap muanjin tjetër kemi mi pas dy drejtora prej kompanisë së ujësjellësit dhe kompanisë së pastrimit edhe i kemi përpara pytni edhe sqaroni unë I kom kry krejt punët për me e leshu ujt, nuk muj me ja ngjit qytetarëve shpenzime të ujit nuk kame bo unë kyqet nuk kame I bo I ka kompania edhe ata vet niher e përgjithëmon përgjesit e Komunës janë kry për ujin po edhe tjetrën, që uji ka me lidh kompania për diskriminim te qytetarëve të Komunës së Drenasit kemin shpenzu bugjet që disa vite por që nuk kan ec përpara edhe ka me shku dikush në pergjesi por ju kom thanë që nuk ka kapacitet të ujit ky është problem për qëta ne e kemi shpall inteses të përgjithshëm liqenin e Verbovcit për të cilin u kriju kodi buxhetor dhe jon nda mjetet dhe qeveria e juja tash naj ka hjek ato mjete, jemi të detyrun me than të vërteten jo me fajsu. Për lehona në qoftë se kemi qoftë se kemi mjete I bojm se edhe ne jemi për me I subvencionu po I ka pas nda. Shtëpia për komunitete nuk e di e shpjegojnë këta, ndërtimi i shkollës nuk besoj që është ndërtim I shkollës është rinovim I shkollës mund të ket ndonjë gabim teknik është rinovim i shkollës Rasim Kiqina, ndërtimi i rrugës Qyqavices 5,000.00 euro, është kod I ndajm mjetet ne qoftë se arrimë me fitu ndonjë grand mund ti qojm atje sepse e kemi kod e kemi një vij buxhetore për bashkëfinancim. Këndi i lojërave nëpër shkolla 40,000.00 euro gjatë proceseve të dëgjimeve vendoset ku me i dërgu ato mjete ndërsa për

gjelbërimin e hapësirave nëpër qytet të Drenasit kudo ka nevojë jo veq te objektet po kudo ku ka nevoj do ta bojm gjelbrimin edhe po mundohmi me bo më të mirën të mundshme.

**Shyqiri Bublaku – Drejtor i Financave,** sa i përket shtëpisë për komunitete ky është një project të cilin e ka kërku niveli qëndror edhe në e kemi fut në buxhetin e Komunës së Drenasit për vitin 2024 ku janë të parapame 230,000.00 € për vitin 2025 janë 230,000.00 dhe për vitin 2026 janë 200,000.00€ kjo është kërkes e nivelit qëndror dhe ne I kemi implementu edhe në draft kornizen afatmesme buxhetore të komunës së Dreansit për vitin 2024-2026. Për persona me aftësi të kufizune është e specifikun.e

**Lumnije Krapi – Drejtoreshë për Shëndetësi,** ne parapraprakisht e kemi pa në buxhet që ata e kan qit si grand të veqant ata I kan qit mjetet unë kom bisedu edhe me doktorin paraprakisht se a kemi pas ndonjë kërkesë për përsonat për ndërtimin e objektit për përsona me aftësi të kufizune mirëpo duhet me u kordinu me ministrin e mirëqenies sociale, që ku I kanë kodu ato dmth ata vet I kan qit për vitin 2024, 230,000,00 € kom diskutu me zyrtarin e financave ministria domethan mjetet që I ka shtesë është një lloj klauzole që I qet për secilen komunë kështu që në qat klauzol e ka përfshi edhe Komunën e Drenasit tash e kan bo kërkesën

**Hamit Kastrati** – deshta të lidhem te korniza afatmesme ku për fshatin Nekoc e Kishnarek janë vetem 80,000.00 euro të ndame ku Nekoc ka ende trotuar pa shtru kemi do projekte hale pa u kry do rrugë e do ndriçim e një pjesë e kanalizimit më shumë ka nëpër do fshatra tjera që i kanë cek këto ndërtimet sesa nëpër fshatrat tjera që janë në mungesë të trotuareve jo vetëm për Nekoc po edhe fshatra tjera për shembull është Arllati është Tërsteniku, fshati Nekoc është njëri ndër ta është më i madh edhe aty ka nevojë për trotuar, nxënësit udhëtojnë deri në 2 km pa trotuar në mes të rrugës e nuk ka trotuar prej lagjes Sylaj deri te shkolla i ka 1 kilometër e diçka, prej lagjes Dugolli deri te shkolla i ka 1 kilometër e gjysmë, dmth 80,000.00 euro është pak. për ketë arsye jam kundër .

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** – Hamit ndëgjimi i parë u bon në sallën e asamblesë, ti si asamblist u dashtë me ardh me përfaqësuesin e Nekocit edhe me propozu buxhetin ju e dini që unë kom thanë ne trotuar ju bëjmë kudo ku ju na krijoni kushtet nëpër fshatra që ka pronë publike as një problem nuk e kem për me shtru trotuar dhe na i konsiderojmë që janë mjete të mjaftueshme për punë që janë mbet në Nekoc pa kry pra kur të vijmë Nekoc ose ku e mbajmë takimin bashkë me juve a ku e mbajmë në Komoran a ku e mbajmë vini e na thoni prej kësaj pikë deri në këtë pikë janë dy kilometra, pronë publike që mundemi me ba trotuarin përgjatë asfaltit edhe na e vendosim në buxhet trotuarin me bo po nëse ne nuk kemi pronë publike unë nuk kam të holla me shpronësu pronën private për me bo trotuarin por ju kom thanë nuk po kemi ku me qit trotuara për shkak të pronës që nuk e kemi pronën tonë, ndriçimi është tuj përfundu mundet me mbet një lagje ose dy lagje është tuj përfundu është kontrate e lidhne e cila u vonu dy vite pothuajse për shkak se e kanë qu në OSHP po u lidh më në fund tuj përfundu është edhe në Nekoc sikur në qdo fshat të komunës ton është tem a voton a se voton është vetem zgjidhje përsonale e juja domethan nuk mundësh thanë që nuk e votoj se nuk keni nda mjete të mjaftushme e konsiderojm është ndëgjim I parë nuk jem duke ja qit pikat në shtator është votimi Hamit, sot ju e votoni në parim për me shku në mbledhje ose mos me shku e jo tjetersen krejt qito votime I votoni I bani në votiime në parim për rekomandim, ia rekomandojmë seancës me

pas ose mos me pas si pikë të rendit të ditës kjo është tëma pra kët tem unë prapse prap unë I qoj pikat të cilat të du se nuk mundet me mi ndal kërkush po këtu diskutohet për tema të cilat janë të përfundume kur të shkojn në seancë për dieni të juven në seancë thot grupi parlamentar i X - partis e ka rekomandu edhe nuk kem nevoj debat shkon edhe del në votim për këta është kjo tem këtu është veq me rekomandu qysh të duash voto je I lir as nuk të ka ba kush presion as nuk ka me tu bo.

**Shyqiri Bublaku –Drejtor i Financave** sa i përket kornizës afatmesme 2024-2026 kjo bëhet në baz të qarkores buxhetore 2024/1 e cila i përket I cakton kufije e jashtëm buxhetor nuk përcaktohen kufijtë për kategorit e shpenzimeve as për paga mallra shërbime komunali subvencione investime kapitale lista e projekteve kapitale është në baz të listës së kërkesave të qytetarëve që i kan bo prej vitit të kaluar e deri më tash por nuk është list përfundimtare e cila ka mu plotsu deri gjat dëgjimeve buxhetore të cilat kemi mi pas edhe muajin Gushtë edhe Shtator këtu është mirë qytetarët kërkesat e veta me Iu dha prioritete e kemi buxhetin kem domethan është 20 milion 29 milion ….e kem material mirëpo këta janë kufijtë e par fillestar dhe ne duhet ta ruajnë masën buxhetore prej 20 milion ….kjo është ajo domethënë ne I kemi zbatu të gjitha rekomandimet e nivelit qendror të ministrisë së financave dhe qarkores së parë buxhetore kjo listë është listë fillestare e cila mundet me u plotësua mundet me u ndryshu me shuma prej tituj të projekteve kjo është listë fillestare mirëpo si kornizë afatmesme buxhetore na duhet ta hartojmë dhe ta dërgojmë në nivelin qendror.

**Hamit Haxhiu**- këtu te infrastruktura rrugore po e shoh që dikun janë 19,000.00 € janë investime për tri vite që më ka bër përshtypje mbi 6 milion euro dhe unë po pajtoj me florentinën se as një specific nuk është unë po e shoh 1 përshembull është rregullimi ose zgjerimi rrjeteve të kanalizimit në Drenas po nuk po e di për qka është fjala për qfar segmenti a po ju kushto shumë me ba pak specifikat kryesore, asfaltimi i një rrugës psh të fshatit Nekoc-Kishnarek, është një afat për tri vjet që realisht asfaltimi i rrugës është dikun 20,000.00 euro qfar segmenti është, për drejtorinë e Arsimit Kabineti në shkolla dhe furnizimi me pasije te TIK-ut nuk e di qfarë dallimi kanë këto dy pika mes vete, kur është fjala për digjitalizimin e shkollave, për qfar kabineti është fjala? Këndi i lojrave, për ne janë avolli këto nuk e di për qfare është fjala, ku behet ky kënd kekroj sqarim më të qartë?

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci –** Hamit e shpjegoj drejtori për mos me i kthy krejt fjalët e tij viti 2024 është buxheti që ne e kem miratu 2025-2026 janë projeksionet në kuadër të këtyre ne na qesin një podë qeveria thotë për kaq vjet i keni kaq mjete, ne i shpërndajmë ne edhe vendosni ju me votën e juaj në kuvendin e komunës kur të vjen në votim gjatë krejt këtyre fazave ne shkojmë nëpër lokacione 5 ose 6 lokacione i mbledhim fshatrat edhe të qytetit e pyesim cilat janë nevojat e juve duke u bazuar edhe në projeksionet e 2022 për 2023 2024 2025 edhe 2026 dmth kto i krijojmë nevojat edhe i qesim në letër kjo duke u ndreq, duke u rregullu këto sene vini në mbledhje me qytetar kur i kemi edhe i qitni kur i keni ndëgju qytetaret duke thanë që në Poklek nuk u bo asgjë e u bon ë Tërstenik edhe në Nekoc shumë këto duhet me i ndëgju qytetarët edhe ne vazhdojmë edhe i zgjedhim këto probleme, domethënë kabineti këto janë projekte ku ka nevojë nëpër shkolla unë nuk i di të gjitha nevojat, këto janë nevojat që ne i kemi kaq mjete për me mujt me i zhvillu këto procedura.

**Arbër Halilaj**-Faleminderit Kryesues ,Kryetar dhe koleg te tjerë, jam shumë pro këtyre kodeve gjelbërimeve të hapësirave publike, ndërtimi shkollës se re "Rasim Kiqina" u kuptua që me kaq mjete mund të bëhet vetëm renovim, të ndërtimi dhe zgjerimi i rrugëve të asfaltuara ne Drenas deshta një sqarim a është parapa zgjerimi i rrugëve ne hyrje te qytetit prej shkollës se mesme në Drenas bashkëfinancim i projektit me donator të jashtëm a është fjala për ndërtimin e ngrohtores së qytetit apo ndonjë projekt tjetër apo është hap si kod nuk shoh financim të aktiviteteve kulturorë përveç renovimi i objekteve sportive, mandej sofra poetike nuk është para pa ne buxhet çka është ne pyetje?

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** hyrja ose zgjerimi prej shkollës se mesme deri në Drenas nuk i kemi në projekt sepse është projekt i qeverise se Kosovës e ka për obligim prej Komoranit e deri ne Gllobar nuk kemi te drejte me i mbyll ato gropa sepse me dërgojnë në përgjegjësi për shkak të keq menaxhimit, jam duke negociuar me ministrin edhe me zhvillua projektin sa ma shpejt edhe sa me mirë në shërbim të qytetarëve të Drenasit dhe gjithë qytetareve të Kosovës, të kodi bashkëfinancim me donatorët nuk ka të bej me nxemje qendrore janë tema që kur kemi donator i zhvillojmë ,shoqëritë kulturore nuk janë investime kapitale janë subvencione ne kuadër te subvencioneve ne i ndajmë aq as kemi mundësi sa e vendosin komisionet, dallojnë këto prej subvencioneve kapitale i kemi edhe shoqëritë kulturore edhe sofrën poetike.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 05 vota (**Për**), 1 votë kundër, 1 votë abstenim, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: 3. **Propozim vendim për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllogoc.**

**Malsore Cakiqi** Përshëndetje për te gjithë, pasi që materialin nuk kemi mujt me pas dhe po kemi problem me emalin zyrtar propozoj qe plani për rregullimin e qytetit të prezantohet me sllajde në monitorin e kuvendit gjatë seancës së rregullt.

**Flutura Avdiu** e nderuar materialin jau kemi përcjell, ndoshta ka ndonjë problem me Email zyrtar, ndërsa propozimin e juaj do të jua përcjellim kompanisë e cila ka hartuar planin besoj që do ta dërgojnë një përfaqësues .

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** - Janë dikun 240 faqe merr kohe dikun 2 javë me prezentu me sllajde, për email nëse ki problem diçka është zyrtari poshtë, kështu qe ta rregullojmë sot çështjen e emalit, nëse e mundur me sllajde me shku çka te është e mundur ne kemi me be ,kompania vjen edhe e shpalos janë 240 faqe për çdo faqe duhet me sqaru .

**Hamit Kastrati** - kryetar 250 sllajde nuk ka nevojë, nuk ka nevojë për çdo faqe me na ni sllajd me be një përmbledhje, e bene një përmbledhje të asaj edhe me qeta vjen e pasqyron në kuvend ta dimë çka është ka bëhet ne kemi materialin mirëpo nuk jam profesion i hartimit te planeve aj

është adekuat për qatë profesion edhe vjen e zbërthen ne mënyrë adekuate dhe ne mënyre profesionale, fletat i ki tekstualisht aj ne baze të asaj vjen edhe e pasqyron ne kuvend.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci** –Hamit a po dini çka po lypni ,ju po doni veç fotografit me jua qit është kompani qe kemi paguar me pare me ba qeta e ki qaty edhe del thu s'po pajtona me qeto voto kundër ose pajtohna me këto votoj për, jeni duke u munduar me ndal zhvillimin e Drenasit, në çka është e mundur me be e bëjmë qka nuk është e mundur nuk mundemi me ba është një plan i cili flet se si ka me u zhvillu Drenasi dhe jo qysh është Drenasi i keni hartat zonale i keni plan zhvillimor e keni ne te gjitha dokumentet e rëndësishme te komunës janë votu flutur ja bene një shkrese kompanisë i thu ju lutem kanë kërkuar asamblistët me ardh me sqaru ma sakte ne i sjellim ,

**Hamit haxhiu** –ta dimë për çka me votu me qenë pak me te qartë në realizimin e projekteve të juaja nuk është problemi veç po dojm me ndal, jem opozitë pe ndalim, nuk ka arsyetime të qarta çështja e votimit problem ma i vogël ti e ke hek obligimin prej teje unë a e votoj a se votoj është ne rregull, unë nuk merma ma me atë pune, mua me pëlqen edhe ta dha votën s'pëlqen skam çka me të bej, shumë para qytetarëve na nuk e dimë as çka mu ndertu as çka ka mu ndertu, ne Poklek kanë me u investu 400 mije euro nuk e di unë as çka ka mu ba as cila rrugë ka mu ndërtu, paska mu be një trotuar po për ku është fjala moti e kam lyp një trotuar qe e meriton me kanë prej ujit të thartë deri te shpija e masakrës, kurrkush nuk ju ka përgjigj nj trotuarit qe masë shumti është 100 metra ,kur është përvjetori i masakrës njerëzit kanë me ec neper asfalt, është një investim tepër i thjesht as unë sot nuk e di çka ka mu ba ne një vend kah kanë me ardh çka ka mu ba, është kjo lexon nuk ka arsyetim, unë po kërkoj thjesht një arsyetim për një projekt, kur e ki mire ke me than mire e ki se me ke bind me ke argumentu edhe ka me ta dhanë votën, mua me intereson zhvillimi i qytetit.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**-e përmende sheshin unë di politika çka është edhe e di kah buron edhe qysh bahet, ju edhe neve edhe veten e keni maltretu për diçka qe nuk keni pas të drejt, ti nuk e ki votu buxhetin po e ka votu shumica e kuvendit, raporti i auditorit na ka qit opinion i kualifikim si rezultat i pasqyrave të pagesave të pasqyrave financiare vendimeve të arsimit dhe shëndetësisë, qaty që pi lypni mëditjet që pi lypni shujtat, që pi lypni transportin qe janë kanë vendime te paligjshme, auditorin nuk i intereson a ka marr vendime të ligjshme a te paligjshme ,ajo po thotë ti i ke shpenzu në kundërshtim me ligjin thesari i ka marr e ka ekzekutu një vendim qe na e kemi refuzu, jo veç na po krejt komunat e Kosovës si rezultatit politike këto politika t qojnë ne këtë drejtim me një memorandum marrëveshje te bashkëpunimit qe e ka lidh x ministria me sindikatat ja ka marr komunës 5milion e 600 mijë nëse s'po gaboj, deri sot nuk na ka penalizu sot po na i humb edhe 3milion të grandit të përformances, 8 milion dëme qe na ka be niveli qendror nuk po them qe cila qeveri se njona u kanë e jona, ne kemi padit qeverinë krejt komunat e kemi padit ministrin e shëndetësisë e kemi padit ministrin e arsimit, tash unë jam i obliguar me e padit edhe zyrën e auditorit edhe thesarin për ekzekutimin e pa drejte te komunës po na dëmtojnë 8 milon euro pa të drejtën tonë, nuk kemi mujt ne ndrysho një projekt që është nënshkru memorandum me qeverinë unë i kam shenu ministrisë për deklaratat qe i keni ba të pabaza edhe marr përgjigje mandej e shohim sepse nuk mundet dikush me ardh me manipulu me

një deklaratë që nuk ja jep, ne me vendim të paligjshme dhe me marrëveshje të ministrisë të pushtetit.

**Hamit Haxhiu,** në fshatin Poklek-Vasilevë dhe Poklek i Ri janë afër 400 mijë euro, nuk i di specifikat ku dhe çka ka me u kry në Poklek, në Vasilevë apo në Poklek të Ri, një nder to më pas e përmenda edhe trotuarin, nuk kushton një trotuar deri tek shpija e masakrës prej ujit të thartë deri tek shpija e masakrës, s'di a janë në pyetje 100 metra.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci**, asnjë dëgjim publik nuk ke ardh, ke ardh në Drenas, hajde bashkë me përfaqësuesin e fshatrave i diskutojmë, krejt këto janë gjera që duhet me marrë pjese në dëgjime buxhetore, ku duhet me mbajt procesverbal raport dhe i shton pikë për grand të përformances, ne i negociojmë, ne jem për interes të qytetareve, ju e keni për obligim deri me 30 gusht.

**Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave-** kjo është listë fillestare e projekteve kapitale e hartuar prej kërkesave nga viti i kaluar dhe këtë vit, kjo nuk do të thotë që mbetet kjo listë, ne kemi me mbajt dëgjime buxhetore ne secilin fshat ku kanë me i pru kërkesat prioritare të vetat, edhe ajo shumë prej 400 mijë euro ka me u specefiku, sepse për ndryshe nuk na u pranohen në Ministrinë e Financave.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 04 vota (**Për**), 1kundër, 2 abstenim, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për financimin e projektit nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale.**

**Lumnije Krapi- Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,** Bazuar në nenin 16 paragrafi 3, të Rregullorës MF-NR. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Nr. 12/320-19338, të dt. 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, është formuar komisioni meVendimin Nr. 01-020/04-24052 e dt. 22.05.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr.06-400/01-22083, të dt. 10.05.2023, të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2023.
Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e aplikantëve për subvencionim të OJQ-ve në bazë të thirrjes publike të lartcekur, ku gjithsej kishin aplikuar dy (dy) OJQ: "HANDIKOS" dhe "BLIRI" .
Pas hapjes se zarfeve të OJQ-ve aplikuese, komisioni ka verifikuar dokumentacionet e dorëzuara të dy organizatave aplikuese, të cilat vazhdojnë të jenë funksionale, mirëpo OJQ "Bliri" nuk i ka përmbushur kriteret e thirrjes publike dhe si rrjedhojë komisioni me vendim përcakton si aplikant i kualifikuar për mbështetje financiare Shoqatën e Personave me Aftësi të Kufizuara "HANDIKOS" Drenas.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-26071, dt.1.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes-kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro.**
Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-28069, dt.13.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes OU Nicrophthalma, në shumën totale prej 3,000.00 euro**
Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim Vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Zveçanit.**

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.**

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u rekomandua për kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Të ndryshme.**
**Nuk pati diskutime.**

**Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 11:10 min .**

**Procesmbajtëse:**

Liridona Fejza-Ajazi

Erlona Gashi

Indira Olluri

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

Milaim Hajdari

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit- Municipality of Drenas

**Zyra e Kryetarit**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 11/07/2023

| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
|---|---|---|---|
| 01 | 070/01-33282 | | |

**Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Sipas këtij udhëzimi, neni 9 Detyrat dhe Përgjegjësitë e kryesuesi të KKSB-së, pika 1.8 është e obliguar të bëhet informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e KKSB-së. Duke u bazuar në këtë udhëzim, ju informojm se në fillim të vitit 2023 me qëllim të realizimit të detyrave operative lidhur me çështjet e Sigurisë në Bashkësi, në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr.04/01-076, për Policinë, nenit 11, pika 2 e udhëzimit administrative nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për KKSB-në, është caktuar orari i punës, ku janë paraparë gjashtë (6) takime të rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, plan ky i cili është miratuar në fillim të vitit fiskal në mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Në periudhën Janar-Qershor janë mbajtur 3 takime të rregullta, përkatësisht me datë 01 Shkurt, 23 Mars, 18 Maj 2023. Në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me sigurinë në bashkësi në Komunën e Drenasit, si siguria e ambientit, siguria shëndetësore, siguria rrugore dhe propozime të tjera, të cilat janë adresuar pastaj edhe në mbledhjet e ekzekutivit. Ndërsa, janë mbajtur edhe tri mbledhje të Këshillit Lokal për Siguri Publike, ku janë trajtuar tema që ndërlidhen me sigurinë publike në komunën e Drenasit.

Në mbledhje janë ftuar anëtarët e KKSB-së dhe monitorues sipas afateve ligjore, përkatësisht 7 ditë para mbajtjes së takimit është dërguar ftesa bashkë me pikat e rendit të ditës, si dhe është publikuar në ueb faqen e komunës së Drenasit. Në mbledhjen e parë të mbajtur me 01 Shkurt janë diskutuar këto pika:

1. *Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 19.12.2023:* [*https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/01/Procesverbali-i-kksb-dhe-ftesa-e-dates-19-dhjetor.pdf*](https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/01/Procesverbali-i-kksb-dhe-ftesa-e-dates-19-dhjetor.pdf)*;*
2. *Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2023;*
3. *Orari i mbajtjes së mbledhjeve të KKSB-së gjatë vitit 2023;*
4. *Raport lidhur me punën e KKSB-së gjatë vitit 2022;*
5. *Raport lidhur me gjendjen në komunën e Drenasit pas vërshimeve;*
6. *Projekti "Integra" apo "Nxitja e riintegrimit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të* rinjve të kthyer dhe njerëzve të cenueshëm lokalë në Kosovë";
7. Të ndryshme

Në këtë mbledhje është miratuar plani dhe orari i mbledhjeve. Ndërsa, në tri pikat e tjera anëtarët kanë raportuar para anëtarëve të KKSB-së, ku edhe janë përgjigjur në pyetjet e adresuara.

Mbledhja e dytë është mbajtur me datë 23 mars ku janë diskutuar temat si në vijim:

1. *Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 01.02.2023:* [*https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/02/Procesverbal-i-KKSB-se.pdf*](https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/02/Procesverbal-i-KKSB-se.pdf)
2. *Siguria në shkolla;*
3. *Të ndryshme*

Në këtë mbledhje është diskutuar çështja e sigurisë në shkolla, dhe me masat që duhet të ndërmerren për parandalim e dukurive negative dhe aktivizimin e të rinjve me aktivitete të cilat i distancojnë nga këto dukuri. Gjithashtu, tema te ndryshme që ndërlidhen me sigurinë. Ndërsa, mbledhja e tretë është mbajtur me datë 18 maj, ku janë diskutuar gjashtë (3) pika si:

1. *Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 23.03.2023:* [https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/04/Procesverbal-i-takimit-te-kksb-se.pdf](https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/04/Procesverbal-i-takimit-te-kksb-se.pdf)

2. *Raport për adresimin e kërkesave të komunës në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore në Prishtinë lidhur me sanimin e gropave nëpër rrugë regjionale.*

3. *Dukuritë negative të adoleshentët dhe veprimet në parandalimin e tyre.*
4. *Të ndryshme*

Edhe në këtë mbledhje janë diskutuar pikat sipas rendit të ditës dhe anëtarët e KKSB-së kanë diskutuar dhe paraqitur kërkesat e tyre lidhur me këto pika.

Për tri mbledhjet janë hartuar edhe procesverbale të cilat në përputhje me Udhëzimin Administrativ janë dërguar tek anëtarët dhe në Divizionin e MPB-së për Siguri në Bashkësi. Të njëjtat janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës brenda afatit ligjor.

Sa i përket Këshillit Lokal për Siguri Publike (KLSP) gjatë kësaj periudhe ka mbajtur tri mbledhje ku janë trajtuar tema që ndërlidhen me Sigurinë Publike në komunën e Drenasit.

Kryetari i komunës

Ramiz Lladrovci

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT PËR VITIN 2022


Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme


Prishtinë, qershor 2023

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT


1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gllogocit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

### Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gllogocit (GLL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gllogocit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 1,130,179€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Prej tyre, 985,078€ ishin pagesa që janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore dhe 145,101€ ishin pagesa që janë kryer nga komuna si rezultat i keq buxhetimit.

A1 Pagesa për punë të cilat nuk ishin realizuar në vlerë prej 95,664€.

A2 Llogaritë e arkëtueshme ishin mbivlerësuar për 38,775€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gllogocit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

### Baza për konkluzion

A3 Ndryshime mbi 10% të vlerës së kontratave pa aplikuar procedurat e prokurimit.

C1 Angazhimi i stafit përmes Marrëveshjeve për shërbime të veçanta për pozita të rregullta të punës.

C2 Mangësi në menaxhimin e të dhënave nga tatimi në pronë.

B2 Mangësi në menaxhimin e pasurive.

B3 Mungesa e projekteve ekzekutuese.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gllogocit.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Gllogocit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gllogocit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gllogocit me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gllogocit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

# 2 Gjetjet dhe rekomandimet[4]

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim rreth menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në komunë ishte përcjellur me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes se PFV-ve. Pas kërkesës sonë, pasqyrat janë korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA dhe disa nga çështjet e ngritura nga ne janë korrigjuar. Mirëpo, gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në ekzekutimin dhe klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e projekteve kapitale, menaxhimin e të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja, katër (4) të përsëritura si dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

**Çështja B1 - Keq klasifikim i shpenzimeve**

**Gjetja**

Udhëzimi administrativ Nr. 19/2009 për planin kontabël, nenit 8.1 dhe 8.3 kanë përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 985,078€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Këto pagesa janë ekzekutuar nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilare, përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve si dhe shujtat. Përkatësisht, për paga dhe mëditje, nga investimet kapitale ishin paguar 702,915€ ndërsa nga mallrat dhe shërbimet ishin paguar 282,163€.

Po ashtu, komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 145,101€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Këto pagesa janë kryer nga komuna si rezultat i keq buxhetimit dhe gabimeve në klasifikimin e shpenzimeve të shkaktuar nga vet komuna dhe kanë të bëjnë me pagesat ndaj furnitorëve të ndryshëm, përkatësisht:

- Nga investimet kapitale ishin paguar 118,958€ për mallra dhe shërbime ngase pagesat ishin për furnizim me pajisje të teknologjisë informative (vlera e pajisjeve për njësi është nën 1,000€) për stafin e komunës, pajisje mjekësore dhe inventar për shkolla; si dhe
- Nga mallrat dhe shërbimet komuna ka paguar 26,143€ për investime kapitale ngase pagesat ishin për pajisje vlera për njësi e të cilave ishte mbi 1,000€.

Keq klasifikimet e shpenzimeve të ekzekutuara nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbarimore ishin për arsye se, sipas komunës këto obligime janë jashtë autoritetit dhe mundësisë për t'i planifikuar për shkak të kufizimeve që imponojnë qarkoret buxhetore të lëshuara nga MFPT për të respektuar kufijtë buxhetor. Ndërsa keq klasifikimet e shpenzimeve tjera ishin për shkak të keq buxhetimit të shkaktuar nga vet komuna.

**Ndikimi** Keq klasifikimi i shpenzimeve rezulton me pasqyrimin jo të drejtë të shpenzimeve në PFV, rrjedhimisht mund të shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

**Çështja A1 - Pagesa për punë të pa kryera**

**Gjetja** Rregulla financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenet 22 deri 26, ndër të tjera përcaktojnë se paraprakisht duhet të bëhet pranimi i pasurive/punëve pastaj duhet të bëhet pagesa. Po ashtu edhe sipas kontratave, pagesat ekzekutohen për punët/pasuritë apo furnizimet e pranuara paraprakisht.

Gjatë ekzaminimit fizik (të realizuar kah fundi i prillit 2023) të dy kontratave, kemi evidentuar pagesa për punë të cilat nuk ishin realizuar. Vlera e përbashkët e pagesave (të realizuara në dhjetor 2022) ishte prej 95,664€, përkatësisht:

- Te kontrata "Ndërtimi i stadionit të qytetit - faza e dytë" prej 1,750,491€, vlera e punëve të paguara por që nuk ishin realizuar është 68,268€. Përkatësisht fjala është për pozicionet 1.1, 4.2, 4.3, 4.4, 5.1, 5.2, 5.3 dhe 5.5 të paguara me situacionin nr. 18 në vlerë prej 100,000€; si dhe
- Te kontrata "Fushat sportive dhe rekreacion LOT 2" prej 49,326€, vlera e punëve të paguara por që nuk ishin realizuar është 27,396€. Projekti është për ndërtimin e dy fushave sportive, njëra në Tërstenik si dhe tjetra në Kizhnarekë. Pagesat për këtë kontratë pothuajse ishin kryer në tërësi, përkatësisht, vlera e paguar ishte 47,006€. Pozicionet e paguara që nuk ishin realizuar janë: V.4, V.5, V.6, dhe V.7 (pozicioni i V.7 ishte realizuar në fushën sportive në Kizhnarekë por jo edhe në Terstenik).

Menaxherët e kontratave na kanë siguruar dëshmi se punët kanë filluar të realizoheshin pas ekzaminimit fizik, ndonëse gjatë kohës sa ishim në ekzekutim të auditimit (deri me 28.04.2023) punët ende nuk ishin përfunduar. Megjithëkëtë, komuna na ka siguruar dëshmi (me dt. 08.06.2023) se tashmë punët ishin realizuar sipas pagesave të kryera.

Shkaku i pagesave për punë të pakryera ishte mos lejimi që mjetet

buxhetore të shkonin në suficit.

**Ndikimi** Pagesat për punë të pa kryera mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit dhe keqpërdorim të parasë publike ngase rritet rreziku i mos realizimit të kontratave nga ana e operatorëve ekonomik.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave aplikojnë kontrolle efektive në procesin e menaxhimit të kontratave dhe të shpenzimit të parasë publike, për tu siguruar se raportet/situacionet për pagesë bëhen vetëm për punët e realizuara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A2 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme nga taksat në ushtrimin e veprimtarisë biznesore**

**Gjetja** Neni 13 i Rregullores komunale Nr. 12-400-16587 për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, ka përcaktuar taksën vjetore me të cilën ngarkohen bizneset për ushtrimin e veprimtarisë afariste/biznesore në territorin e Komunës së Gllogocit. Faturimet bëhen sipas kodeve të përcaktuara për disa veprimtari biznesore (duhet theksuar se jo të gjitha kodet e përcaktuara nga Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës - ARBK ishin të përfshira në rregulloren komunale).

Nga analizimi i bazës së ngarkesave për vitin 2022, kemi evidentuar mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme prej 38,775€, përkatësisht:

- Në 13 raste bizneset ishin ngarkuar me taksë vjetore me vlerë totale prej 10,160€, kodet e veprimtarive të të cilave nuk ishin të parapara në rregulloren komunale. Prej tyre kishin paguar dy (2) biznese prej 1,180€ duke rezultuar me mbivlerësim prej 8,980€;
- Në 17 raste bizneset ishin ngarkuar me taksë vjetore me vlerë totale prej 29,450€ sipas kodit jo adekuat të veprimtarisë, ndërsa ngarkesat e duhura bazuar në kodet e parapara me rregullore duhej të ishin prej 10,350€, prej tyre, tre (3) biznese kishin paguar prej 10,000€ duke rezultuar me mbivlerësim prej 9,100€; si dhe
- Në 51 raste ishin ngarkuar me taksë vjetore me vlerë prej 20,695€ bizneset e themeluara si Biznese Individuale (B.I.), Ndërmarrje Tregtare Prodhuese (NTP) dhe Ndërmarrje Shoqërore (NSH), mirëpo të njëjtat sipas nenit 13.3 të rregullores janë të liruara nga pagesa e taksës komunale deri në kohë të pacaktuar.

Sipas zyrtarëve komunal kjo gjendje ishte për shkak të mangësive në rregulloren komunale si dhe gabimeve gjatë ngarkesave/faturimeve në softuerin e menaxhimit të të hyrave nga taksa në ushtrimin e veprimtarisë biznesore, ku ngarkesat/faturimet nuk gjeneroheshin direkt nga sistemi por ato duhet të bëhen manualisht. Ndërsa ngarkesat e bizneseve të liruara sipas nenit 13.3 ishte bërë bazuar në kodet e përcaktuara me rregullore. Duhet theksuar se komuna në raste të caktuara, kishte përfillur kërkesat e rregullores dhe kishte bërë korrigjimin e ngarkesave sipas rregullores komunale.

**Ndikimi** Ngarkesat e bizneseve pa bazë në rregulloren komunale ka ndikuar në mbivlerësimin e llogarive të arkëtueshme në PFV. Po ashtu, ngarkesat pa bazë paraqesin diskriminim në trajtimin e bizneseve, mund të ndikojë në konkurrencën e tregut si dhe mund të rezultojë me konteste gjyqësore të

humbura nga komuna për shkak të arkëtimit të të hyrave pa bazë ligjore.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë se taksa për ushtrimin e veprimtarisë biznesore ngarkohet ndaj bizneseve sipas rregullores komunale e cila tashmë ishte në proces të plotësim ndryshimit si dhe të siguroj se përdoren softuer/sisteme efikase dhe efektive për menaxhimin e të hyrave nga taksat në biznese. Po ashtu, komuna duhet të bëj marrëveshje me bizneset lidhur me mjetet financiare të paguara pa bazë në rregulloren komunale (mjetet financiare duhet t'u kthehen apo kartela e tyre financiare të vendoset në parapagim pasi që me rregulloren e re parashihet të përfshihen të gjitha kodet e veprimtarive sipas ARBK-së).

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

**Çështja A3 - Ndryshime mbi 10% të vlerës së kontratave pa aplikuar procedurat e prokurimit**

**Gjetja**

Neni 61.21 i RrUOPP specifikon se "Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer", neni 61.22 thotë se "ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit", ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet "vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ". Po ashtu, interpretimi i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) ka përcaktuar se ndryshimet e kontratave mund të aplikohen pa procedura të reja të prokurimit vetëm nëse vlera financiare e këtyre ndryshimeve nuk është me shumë se 10% e vlerës se kontratës.

Kemi evidentuar tre raste në të cilat kishte pasur ndryshime në kontrata mbi 10% të vlerës totale të kontratave. Këto ndryshime kanë të bëjnë me sasitë e realizuara në pozicione të caktuara të cilat ishin kryesisht ishin aprovuar nga zyra e prokurimit dhe Kryetari pa aplikimin e procedurave të prokurimit. Përkatësisht kjo dukuri është identifikuar në këto kontrata:

- Te kontrata "Ndërtimi i stadionit të qytetit - faza e dytë" prej 1,750,491€, ndryshimet ishin në 22 pozicione me vlerë prej 233,237€ apo rreth 13% e vlerës së kontratës, duhet theksuar se, përveç mos aplikimit të procedurave të prokurimit, për shumicën e këtyre ndryshimeve në pozicione nuk na janë siguruar as dëshmitë e aprovimeve nga zyra e prokurimit dhe ZKA.
- Te kontrata "Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën e Drenasit" prej 215,556€, kemi evidentuar se katër (4) pozicione nuk ishin realizuar, për të mundësuar rritjen e sasive në një pozicion tjetër prej 31,448€ apo rreth 14% të vlerës së kontratës. Çmimi për njësi i kontraktuar sasia e të cilit është rritur, ishte Gypa HDPE SN/8 Ø250 mm prej 16€ (pozicioni 5.1). Përderisa, në anën tjetër, çmimet e pozicioneve të cilat nuk janë realizuar ishin jo normalisht të ulëta dhe nuk ishin trajtuar si të tilla gjatë vlerësimit të tenderit. Përkatësisht, pozicioni 5.0 Gypa HDPE SN/8 Ø200 mm prej 1.01€, pozicioni 5.3 Gypa HDPE SN/8 Ø400 mm prej 4.99€, pozicioni 5.4 Gypa HDPE SN/8 Ø500 mm prej 8.2€ si dhe pozicioni 5.5 Gypa HDPE SN/8 Ø630 mm prej 9.1€.
- Te kontrata "Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas" prej 176,209€, përkundër se në këtë projekt ishte aplikuar një aneks kontratë sipas rregullave të prokurimit në vlerë prej 17,201€, kemi evidentuar edhe ndryshime tjera në 43 pozicione prej 48,700€ apo 27% të vlerës së kontratës.

Sipas sqarimeve të zyrës së prokurimit, mos aplikimi i procedurave të prokurimit për këto ndryshime ishte për shkak të mungesës së njohurive lidhur me ndryshimet në rregullat e prokurimit publik.

**Ndikimi**

Ndryshimi i kontratave pa procedura të reja të prokurimit mbi përqindjen e lejuar, shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti, dhe mund të rezultojë që për shkak të realizimit të kontratës me kushte të ndryshuara nuk është përzgjedhur operatori më i lirë.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave dhe zyra e prokurimit janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve). Çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit, do të bëhet vetëm pas sigurimit se kjo është në pajtim të plotë me kërkesat ligjore në fuqi lidhur me ndryshimin e kontratave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja C1 - Angazhimi i stafit përmes Marrëveshjeve për shërbime të veçanta për pozita të rregullta të punës**

**Gjetja** Sipas Ligjit Nr. 06/L-0114 për zyrtarët, përkatësisht nenit 84, përcakton se "Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik". Përderisa neni 59 i RRUOPP ka përcaktuar qëllimin dhe procedurën e prokurimit publik lidhur Marrëveshjet për shërbime të veçanta. Përkatësisht, neni 59.1 ndër të tjera definon "shërbimet konsulente"- të cilat nënkuptojnë një shërbim të një natyre intelektuale apo konsultative, që furnizohet nga një konsulent ekspert dhe i kualifikuar në një fushë të caktuar apo profesion dhe përfshin shërbime ku aspektet intelektuale dhe kontributet mbizotërojnë dhe tejkalojnë aspektet tjera fizike të kontratës.

Kemi evidentuar se komuna kishte angazhuar gjashtë (6) persona sipas marrëveshjeve për shërbimeve të veçanta përmes procedurave të prokurimit. Mirëpo, stafi i angazhuar ishin për punë dhe detyra të rregullta pune që duhet të kryhen nga stafi i rregullt i komunës. Vlera e kompensimit gjatë vitit 2022 për stafin e angazhuar në këtë formë ishte prej 10,226€.

Sipas zyrtareve komunal kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së vendeve të lira për rekrutimin e stafit të rregullt (ku me rastin e krijimit të vendeve të lira, dy prej tyre ishin punësuar si staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit).

**Ndikimi** Angazhimi i stafit sipas marrëveshjeve për shërbimeve të veçanta për pozita të rregullta mund të rrit kostot e komunës krahasuar me kostot e rekrutimit të stafit të rregullt si dhe mund të rezultojë se angazhohet staf jo përkatës, duke ndikuar në arritjen e objektivave të komunës.

**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të sigurojë se për pozita të rregullta të punës angazhohet staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit dhe se procedurat e prokurimit për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta aplikohen vetëm për pozita specifike dhe të veçanta të cilat nuk mund të mbulohen nga stafi i brendshëm i komunës.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin e të dhënave nga tatimi në pronë**

**Gjetja**

Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit me nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme - Zbritja për vendbanimin parësor, paraqet: "Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në Komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000€) nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit".

Nga analiza e shënimeve në bazën e të dhënave të Protax-it kemi identifikuar 12 raste në të cilat zbritja prej 15,000€ për vendbanimin parësor ishte aplikuar dy herë te tatimpaguesit e njëjtë. Si rezultat, për arsye të nën-faturimit të hyrat janë më të vogla për 270€.

Sipas zyrtarëve komunal kjo gjendje për shkak të bashkimit të tatimpaguesve të cilit ishin të ndarë por të cilit nuk ishin pranuar në sistemin Protax për arsye të çështjeve teknike.

**Ndikimi**

Dobësitë e identifikuara lidhur me menaxhimin e të dhënave të tatimit në pronë, respektivisht mos përditësimi i informatave të tatimpaguesve, ndikon në nënvlerësimin/mbivlerësimin e bazës tatimore, me çka krijohen paqartësi dhe jo siguri në bazën e të dhënave për tatimpaguesit.

**Rekomandimi C2**

Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në sektorin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin Protax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të komunës dhe me ligjin e tatimit në pronë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Mangësi në menaxhimin e pasurive**

**Gjetja**

Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare thotë se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Po ashtu, neni 19.4.3 i kësaj rregulloreje përcakton se duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare.

Kemi evidentuar se pagesat e kontratës "Furnizimi i shkollave me kabinete për kimi, fizikë dhe biologji" prej 48,818€ janë regjistruar në sistemin E pasuria, përderisa kjo është dashur të bëhej në SIMFK sipas vlerës së furnizimeve për kabinete përkatëse.

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Mangësitë në regjistrimin e pasurive si dhe procesin e inventarizimit, kryesisht ishin për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit të pasurive.

| | |
|---|---|
| Ndikimi | Regjistrimi jo adekuat i pasurive ka ndikuar në nënvlerësimin e pasurive kapitale për 48,818€ si dhe mbivlerësimin e pasurive jo kapitale për vlerën e njëjtë. Ndërsa, mos krahasimi i inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive nuk jep siguri lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë. |
| Rekomandimi B2 | Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu, duhet siguruar se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B3 - Mungesa e projekteve ekzekutuese**

| | |
|---|---|
| Gjetja | Neni 20 pika 10 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RrUOPP) kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.<br><br>Nga 64 projekte kapitale në të cilat kishte shpenzim gjatë vitit 2022, kemi identifikuar se për 41 kontrata pune, Komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar proceduarat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë.<br><br>Shkaku i mungesës së projekteve ekzekutuese sipas zyrtarëve të komunës ishte mungesa e buxhetit për kontraktimin e një operatori për hartimin e projekteve ekzekutive. |
| Ndikimi | Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari, rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve. |
| Rekomandimi B3 | Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues, të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme e shpalosur në PFV ishte 3,754,913€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë, taksa në ushtrimin e veprimtarisë biznesore, qiratë, lejet ndërtimore etj.

**Çështja B4 - Menaxhimi jo efektiv i llogarive të arkëtueshme**

**Gjetja**

Sipas nenit 16 të Rregullore MF- nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara.
Po ashtu, arkëtimi i të hyrave duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Krahasuar me vitin paraprak rritja totale e të arkëtueshmeve ishte rreth 424,273€ apo rreth 12%. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë, përkatësisht në vlerë 1,843,543€ apo rreth 49%, taksës në biznese 1,361,734€ rreth 36%, qiratë 527,520€ rreth 14% si dhe lejet ndërtimore 19,573 rreth 1%.

Përkundër disa masave të ndërmarra, rritja e llogarive të arkëtueshme vit pas viti ishte për shkak të mos marrjes së të gjitha veprimeve të mundshme për arkëtimin e tyre.

**Ndikimi**

Mos aplikimi i mekanizmave të përcaktuar me ligj dhe rregullore përkatëse ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, që rezulton me fonde më të pakta për arritjen e synimeve dhe mund të ndikoj edhe tek debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

**Rekomandimi B4**

Kryetari, duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet e mundshme përfshirë edhe ato ligjore, për të siguruar efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

# 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final[5] | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet | 2020 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Burimet e fondeve** | **15,846,091** | **18,512,652** | **17,510,741** | **15,432,138** | **15,583,238** |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 14,636,105 | 15,502,612 | 14,981,037 | 13,060,000 | 13,832,852 |
| Financimi përmes huamarrjes | 0 | 127,905 | 127,905 | 71,560 | 116,583 |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0 | 1,165,018 | 957,593 | 842,370 | 571,822 |
| Të hyrat vetanake | 1,209,986 | 1,209,986 | 939,348 | 926,588 | 716,372 |
| Donacionet vendore | 0 | 2,213 | 0 | 11,008 | 20,351 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 504,918 | 504,858 | 520,613 | 325,257 |

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,666,561€. Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes së grantit të qeverisë për 866,507€, rritjes së të hyrave të bartura nga viti paraprak për 1,165,018€, rritjes së donacioneve të brendshme për 2,213€, rritjes së financimit nga huamarrja prej 127,905€ si dhe donacioneve të jashtme për 504,917€.

Në vitin 2022 OB ka shpenzuar rreth 95% të buxhetit final, me një rritje prej rreth 13% në krahasim me vitin 2021.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet | 2020 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike** | **15,846,091** | **18,512,652** | **17,510,741** | **15,432,138** | **15,583,238** |
| Pagat dhe mëditjet | 8,700,000 | 9,694,412 | 9,671,999 | 8,914,997 | 8,524,870 |
| Mallrat dhe shërbimet | 2,100,000 | 2,524,342 | 2,143,765 | 1,411,089 | 1,361,893 |
| Komunalitë | 298,508 | 298,508 | 275,283 | 213,075 | 194,766 |
| Subvencionet dhe transferet | 420,000 | 466,858 | 413,004 | 380,103 | 430,331 |
| Investimet Kapitale | 4,117,237 | 5,416,657 | 5,006,690 | 4,512,873 | 5,071,378 |
| Rezervat | 210,346 | 111,875 | 0 | 0 | 0 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

• Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 994,412€. Rritja ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë prej 866,507€, për të mbuluar ndikimin negativ të pagesave të ekzekutuara nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbarimore, si dhe rritjes nga buxheti i ndarë nga vendimet e Qeverisë në kuadër të fondit të rimëkëmbjes ekonomike prej 127,905€.
• Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 424,342€ nga të hyrat e bartura;
• Buxheti për subvencione ishte rritur për 46,858€ nga të hyrat e bartura.
• Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 1,200,949€. Rritja ishte nga të hyrat e bartura për 693,819€, nga donacionet e brendshme për 2,213€ si dhe nga granti i performancës prej 504,917€.

Sipas të dhënave në SIMFK, shpenzimet gjatë vitit 2022 për projektin 00098 ishin 127,905€. Ato janë realizuar nga Programi për rimëkëmbje ekonomike dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave/shtesave të stafit në sektorin e shëndetësisë sipas vendimeve të nivelit qendror.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022




Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2022 ishin 1,509,673€ apo rreth 30% më shumë se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet | 2020 Pranimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i të hyrave** | **1,209,986** | **1,209,986** | **1,509,673** | **1,167,354** | **885,917** |
| Të hyrat tatimore | 667,491 | 667,491 | 674,100 | 716,423 | 452,717 |
| Të hyrat jo tatimore | 542,495 | 542,495 | 835,572 | 450,932 | 432,268 |
| Të hyrat tjera | 0 | 0 | | | 932 |

# 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 ka rezultuar në 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Mirëpo, komuna nuk ka raportuar me kohë lidhur me zbatimin e rekomandimeve përmes raportit periodik të zbatimit të rekomandimeve që ishte dashur të dorëzohej me me 15.03.2023. Deri në fund të auditimit për vitin 2022, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar, për katër (4) rekomandime nuk ka filluar zbatimi si dhe dy (2) ishin në proces të zbatimit, siç është paraqitur më poshtë në Grafikun 2. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2021 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit. | Rekomandimi është pjesërisht i zbatuar ngase janë aplikuar procedurat e prokurimit për angazhimin e stafit përmes MShV. | Pjesërisht i zbatuar |
| 2. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë planifikim të buxhetit adekuat, si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të kryerjes së gjitha detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik. | Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | I zbatuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara. | Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | I zbatuar |
| 4. | Baza për konkluzion | Kryetari të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerje dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa. | Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | I zbatuar |
| 5. | Pasqyrat Financiare Vjetore | Kryetari duhet të sigurojë që përmes personave përgjegjës, gjatë hartimit të pasqyrave për vitin 2022, ti kushtohet vëmendje që mos të kenë gabime kontabël dhe administrative dhe të gjithë zërat në pasqyrat financiare të jenë drejtë dhe të sakta. | Janë marrë me kohë veprimet e nevojshme dhe korrigjimi i PFV-ve është brenda afatave të lejuara. | I zbatuar |
| 6. | Të hyrat | Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin Protax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të komunës dhe me ligjin e tatimit në pronë. | Edhe këtë vit kemi identifikuar dukurinë e zbritjes së pa rregullt prej 15,000€ për vendbanimin parësor. | Pjesërisht i zbatuar |
| 7. | Të hyrat | Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluar të dorëzohen me kohë në arkë dhe të depozitohen në bankë në harmoni me kërkesat e rregullës financiare për të hyrat. | Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | I zbatuar |
| 8. | Subvencionet dhe transferet | Kryetari, duhet të sigurojë se subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike dhe të siguroj se Organizatat jo qeveritare të mos përfitojnë subvencione pa i plotësuar/pagatitur projektin dhe formularin e buxhetit. | Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | I zbatuar |
| 9. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të saktë sipas kodeve ekonomike adekuate. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 10. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimi |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 11. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të siguroj që, përmes menaxherit të prokurimit, si dhe menaxherëve të kontratave, se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat e parapara në kontratë. | Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | I zbatuar |
| 12. | Pasuritë | Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 13. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e tyre, duke mos përjashtuar edhe masat juridike. Po ashtu të siguroj funksionimin e sistemit për licencat e biznesit që të gjeneroj raporte sipas informatave të nevojshme për komunën. | Ka rritje të llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë dhe qirat, si dhe nuk janë ndërmarr veprime për arkëtimin e taksave për biznes. | Nuk ka filluar zbatimi |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit

Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit

Hysen Restelica, Anëtar i ekipit

# Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

| Çështja | Komenti i OB-së | Pikëpamja e ZKA-së |
|---|---|---|
| Keq klasifikim i shpenzimeve | Vlera prej 985.078 € është paguar me Vendime të Gjykatës për obligimet që rrjedhin nga Kontratat kolektive në sektorin e Arsimit dhe sektorin e Shëndetësisë për të cilat Komuna e ka pasur të pa mundur të ndërmarrë diçka, sepse, kufijtë buxhetor kanë qenë të përcaktuar sipas Qarkores buxhetore 2021/1 dhe 2022/2. Andaj, me mirëkuptim kërkojmë nga Ju që kjo shumë të mos merret parasysh sipas materialitetit, sepse, është në tërësi jashtë mundësive të Komunës. | Gjetja e auditimit është e qëndrueshme. Komenti i zyrtarëve komunal lidhur me këtë gjetje nuk ka të bëj me kundërshtimin e gjendjes së konstatuar, por vetëm me aspektin që kjo çështje të mos merret parasysh sipas materialitetit, rrjedhimisht të mos ndikoj në opinionin e auditimit. |

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Drenasit**

Zyra e Kryetarit

**01 Nr.**052-27725 **dt.**09 06 **2023**

# LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar Draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Komunës së Gllogocit**, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");

- Pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, përveç pikës B1, si vijon: Në pajtim me nenin 45 të Kontratës Kolektive, decidivisht shkruan:

  "MASH dhe SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t'i informuar dhe ndihmuar komunat"...gjë e cila nuk ka ndodhur. MFT ka rritur shumën në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për mbulimin e këtyre shpenzimeve, por, jo në shumën e mjaftueshme për mbulimin e tërësishëm të tyre.

  Prandaj, Vlera prej 985.078 € është paguar me Vendime të Gjykatës për obligimet që rrjedhin nga Kontratat kolektive në sektorin e Arsimit dhe sektorin e Shëndetësisë për të cilat Komuna e ka pasur të pa mundur të ndërmarrë diçka, sepse, kufijtë buxhetor kanë qenë të përcaktuar sipas Qarkores buxhetore 2021/1 dhe 2022/2. Andaj, me mirëkuptim kërkojmë nga Ju që kjo shumë të mos merret parasysh sipas materialitetit, sepse, është në tërësi jashtë mundësive të Komunës.

- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Më, 9.6.2023

Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Drenasit

# Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[6] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[7], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**
*Forma e opinionit*

**Opinioni i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

**Opinioni i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinion i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

***Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit***

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[6] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[7] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**Komuna e Drenasit**

**Zyra e Kryetarit**

01 **Nr.-** 400/01 – 30656 **dt.27.06.2023**

**Për:** Zyra Kombëtare e Auditimit, znj.Vlora Spanca

**Nga :** Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit

**Lënda:** Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: *" Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2022.*

Në pajtim me nenin 14 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, si dhe duke u mbështetur në Procedurat Standarde të Trajtimit të Rekomandimeve të Zyres Kombëtare të Auditimit , po ju dërgojmë Planin e veprimit për zbatimin e Rekomandimeve që dalin nga Raporti i auditimit me temen ***"Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2022 "***

## PLANI I VEPRIMIT

**PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE QË DALIN NGA RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE VJETORE FINACIAR TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN FISKAL 2022**

| Nr. | Kompone-nta e auditimit (kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e Planifikuara për t'u ndërmarrë | Zyrtari/ët përgjegjës | Afatet për Impleme-ntim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1<br>B1 | **Keq klasifikimi i shpenzime-ve në kategori dhe kode ekonomike** | Udhëzimi administrativ Nr. 19/2009 për planin kontabël, nenit 8.1 dhe 8.3 kanë përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike. Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 985,078€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Këto pagesa janë ekzekutuar nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore dhe kanë të bëjnëme kompensimin e pagave jubilare, përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve si dhe shujtat. Përkatësisht, për paga dhe mëditje, nga investimet kapitale ishin paguar 702,915€ ndërsa nga | Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate. | Do të kërkohet edhe shtim të masës buxhetore për këtë kategori të shpenzimeve nga Ministria e Financave, meqenëse shpenzimet që kanë dalë nga kontratat kolektive-sektoriale, me qarkore Buxhetore nuk mund të planifikohen.<br><br>Sa i përket pagesave nën 1,000.00 euro dhe mbi 1,000.00 euro te pajisjet, do të shtohet kujdesi në pagesën e secilit shpenzim sipas kategorisë. | Zyrtarët Financiar të sektorëve dhe ZKF | 2023-2024 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mallrat dhe shërbimet ishin paguar 282,163€.<br>Po ashtu, komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 145,101€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Këto pagesa janë kryer nga komuna si rezultat i keq buxhetimit dhe gabimeve në klasifikimin e shpenzimeve të shkaktuar nga vet komuna dhe kanë të bëjnë me pagesat ndaj furnitorëve të ndryshëm, përkatësisht:<br>• Nga investimet kapitale ishin paguar 118,958 për mallra dhe shërbime ngase pagesat ishin për furnizim me pajisje të teknologjisë informative (vlera e pajisjeve për njësi është nën 1,000 ) për stafin e komunës, pajisje mjekësore dhe inventar për shkolla; si dhe<br>• Nga mallrat dhe shërbimet komuna ka paguar 26,143€ për investime kapitale ngase pagesat ishin për pajisje vlera për njësi e të cilave ishte mbi 1,000<br>Keq klasifikimet e shpenzimeve të ekzekutuara nga Thesari sipas vendimeve | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | gjyqësore/përmbarimore ishin për arsye se, sipas komunës këto obligime janë jashtë autoritetit dhe mundësisë për t'i planifikuar për shkak të kufizimeve që imponojnë qarkoret buxhetore të lëshuara nga MFPT për të respektuar kufijtë buxhetor. Ndërsa keq klasifikimet e shpenzimeve tjera ishin për shkak të keq buxhetimit të shkaktuar nga vet komuna. | | | | |
| 2<br>A1 | **Pagesa për punë të pa-kryera** | Rregulla financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenet 22 deri 26, ndër të tjera përcaktojnë se paraprakisht duhet të bëhet pranimi i pasurive/punëve pastaj duhet të bëhet pagesa. Po ashtu edhe sipas kontratave, pagesat ekzekutohen për punët/pasuritë apo furnizimet e pranuara paraprakisht.<br>Gjatë ekzaminimit fizik (të realizuar kah fundi i prillit 2023) të dy kontratave,kemi evidentuar pagesa për punë të cilat nuk ishin realizuar. Vlera e përbashkët e pagesave (të realizuara në dhjetor 2022) ishte prej 95,664€, përkatësisht:<br>Te kontrata "Ndërtimi i stadionit të qytetit - faza e dytë" prej 1,750,491€, vlera e punëve të paguara por që nuk ishin realizuar | Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave aplikojnë kontrolle efektive në procesin e menaxhimit të kontratave dhe të shpenzimit të parasë publike, për tu siguruar se raportet/situacionet për pagesë bëhen vetëm për punët e realizuara. | Do të shtohen kontrollet në terren për realizimin e projekteve si dhe nuk do të lejohen pagesa pa përfunduar punët sipas situacioneve për punët e realizuara.<br>Do të njoftohen menaxherët e kontratave për zbatimin e rregulloreve rreth rekomandimit të pagesave. | Të gjithë menaxherët të cilët caktohen me vendim. | I menjë-hershem |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | është 68,268€. Përkatësisht fjala është për pozicionet 1.1, 4.2, 4.3, 4.4, 5.1, 5.2, 5.3 dhe 5.5 të paguara me situacionin nr. 18 në vlerë prej 100,000 ; si dhe<br>Te kontrata "Fushat sportive dhe rekreacion LOT 2" prej 49,326 , vlera e punëve të paguara por që nuk ishin realizuar është 27,396€. Projekti është për ndërtimin e dy fushave sportive, njëra në Tërstenik si dhe tjetra në Kizhnarekë. Pagesat për këtë kontratë pothuajse ishin kryer në tërësi, përkatësisht, vlera e paguar ishte 47,006€. Pozicionet e paguara që nuk ishin realizuar janë: V.4, V.5, V.6, dhe V.7 (pozicioni i V.7 ishte realizuar në fushën sportive në Kizhnarekë por jo edhe në Terstenik).<br>Menaxherët e kontratave na kanë siguruar dëshmi se punët kanë filluar të realizoheshin pas ekzaminimit fizik, ndonëse gjatë kohës sa ishim në ekzekutim të auditimit (deri me 28.04.2023) punët ende nuk ishin përfunduar. Megjithëkëtë, komuna na ka siguruar dëshmi (me dt. 08.06.2023) se tashmë punët ishin realizuar sipas pagesave të kryera. | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shkaku i pagesave për punë të pakryera ishte mos lejimi që mjetet buxhetore të shkonin në suficit. | | | | |
| 3<br><br>A2 | **Mangësi në menaxhi-min e llogarive të arkëtue-shme nga taksat në ushtrimin e veprimtari-së biznesore** | Neni 13 i Rregullores komunale Nr. 12-400-16587 për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, ka përcaktuar taksën vjetore me të cilën ngarkohen bizneset për ushtrimin e veprimtarisë afariste/biznesore në territorin e Komunës së Gllogocit. Faturimet bëhen sipas kodeve të përcaktuara përdisa veprimtari biznesore (duhet theksuar se jo të gjitha kodet e përcaktuara nga Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës - ARBK ishin të përfshira në rregulloren komunale).<br>Nga analizimi i bazës së ngarkesave për vitin 2022, kemi evidentuar mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme prej 38,775€, përkatësisht:<br>• Në 13 raste bizneset ishin ngarkuar me taksë vjetore me vlerë totale prej 10,160€, kodet e veprimtarive të të cilave nuk ishin të parapara në rregulloren komunale. Prej tyre kishin paguar dy (2) biznese prej 1,180€ duke | Kryetari duhet të sigurojë se taksa për ushtrimin e veprimtarisë biznesore ngarkohet ndaj bizneseve sipas rregullores komunale e cila tashmë ishte në proces të plotësim ndryshimit si dhe të siguroj se përdoren softuer/sisteme efikase dhe efektive për menaxhimin e të hyrave nga taksat në biznese. Po ashtu, komuna duhet të bëj marrëveshje me bizneset lidhur me mjetet financiare të paguara pa bazë në rregulloren komunale (mjetet financiare duhet t'u kthehen apo kartela e tyre financiare të vendoset në parapagim pasi që me rregulloren e re parashihet të përfshihen të gjitha kodet e veprimtarive sipas ARBK-së). | Gjatë muajve vijues do të fillojmë me procedurat e aplikimit të softuerit të ri për menaxhimin e të hyrave nga taksat në biznese.<br><br>Rregullorja komunale për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, është në proces të plotësim ndryshimit. Në rregulloren e re parashihet rregullimi i tërësishëm i këtyre çështjeve. | DZHE dhe DBF Zyrtarët e taksës dhe shefi.<br><br>Komisioni është në përfundim të draftit final të hartimit të rregullores në fjalë. | Korrik-Tetor<br><br>DZhE dhe DI<br><br>Gjashtë-mujori i dytë-2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | rezultuar me mbivlerësim prej 8,980€;<br>• Në 17 raste bizneset ishin ngarkuar me taksë vjetore me vlerë totale prej 29,450€ sipas kodit jo adekuat të veprimtarisë, ndërsa ngarkesat e duhura bazuar në kodet e parapara me rregullore duhej të ishin prej10,350 , prej tyre, tre (3) biznese kishin paguar prej 10,000 duke rezultuar me mbivlerësim prej 9,100€; si dhe<br>• Në 51 raste ishin ngarkuar me taksë vjetore me vlerë prej 20,695€ bizneset e themeluara si Biznese Individuale (B.I.), Ndërmarrje Tregtare Prodhuese (NTP) dhe Ndërmarrje Shoqërore (NSH), mirëpotë njëjtat sipas nenit 13.3 të rregullores janë të liruara nga pagesa e taksës komunale deri në kohë të pacaktuar.<br><br>Sipas zyrtarëve komunal kjo gjendje ishte për shkak të mangësive në rregulloren | Lidhur me mjetet financiare të paguara nga ana e operatorëve ekonomikë, kartelat e tyre financiare do të vendosen në parapagim. | DZhE - Zyrtarët e taksës dhe shefi | Gjashtë-mujori i dytë-2023<br><br>Gjashtë-mujori i dytë-2023 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | komunale si dhe gabimeve gjatë ngarkesave/faturimeve në softuerin e menaxhimit të të hyrave nga taksa në ushtrimin e veprimtarisë biznesore, ku ngarkesat/faturimet nuk gjeneroheshin direkt nga sistemi por ato duhet të bëhen manualisht. Ndërsa ngarkesat e bizneseve të liruara sipas nenit 13.3 ishte bërë bazuar në kodet e përcaktuara me rregullore. Duhet theksuar se komuna në raste të caktuara, kishte përfillur kërkesat e rregullores dhe kishte bërë korrigjimin e ngarkesave sipas rregullores komunale. | | | | |
| 4<br><br>A3 | **Ndryshime mbi 10% të vlerës së kontratave pa aplikuar procedurat e prokurimit** | Neni 61.21 i RrUOPP specifikon se "Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer", neni 61.22 thotë se "ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit", ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet "vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ". Po ashtu, interpretimi i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) ka përcaktuar se ndryshimet e kontratave mund të aplikohen pa procedura të reja të | Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave dhe zyra e prokurimitjanë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve). Çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit, do të bëhet vetëm pas sigurimit se kjo është në pajtim të plotë me kërkesat ligjore në fuqi | Zyra e Prokurimit pas çdo kërkese të paraqitur nga njësia kërkuese apo menaxherët e kontratave do t'i shqyrtoj dhe në bazë të ligjit të LPP-se dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit, do të ndërmarrë vendime në bazë të kërkesave të njësive kërkuese.<br>Zyra e Prokurimit ju siguron se çdo vendim që aprovon ose refuzon do ta bëj në bazë të legjislacionit në fuqi dhe | Udhëheqësi i prokurimit | Në vazhdi-mësi |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | prokurimit vetëm nëse vlera financiare e këtyre ndryshimeve nuk është me shumë se 10% e vlerës se kontratës.<br>Kemi evidentuar tre raste në të cilat kishte pasur ndryshime në kontrata mbi10% të vlerës totale të kontratave. Këto ndryshime kanë të bëjnë me sasitë e realizuara në pozicione të caktuara të cilat ishin kryesisht ishin aprovuar nga zyra e prokurimit dhe Kryetari pa aplikimin e procedurave të prokurimit. Përkatësisht kjo dukuri është identifikuar në këto kontrata:<br>• Te kontrata "Ndërtimi i stadionit të qytetit - faza e dytë" prej 1,750,491€, ndryshimet ishin në 22 pozicione me vlerë prej 233,237€ apo rreth 13% e vlerës së kontratës, duhet theksuar se, përveç mos aplikimit të procedurave të prokurimit, për shumicën e këtyre ndryshimeve në pozicione nuk na janë siguruar as dëshmitë e aprovimeve nga zyra e prokurimit dhe ZKA.<br>• Te kontrata "Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën | lidhur me ndryshimin e kontratave. | do të jemi të vëmendshëm për çdo ndryshim të legjislacionit në mënyrë që vendimet apo procedurat tona të jenë në përputhje me këto ndryshime. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | e Drenasit" prej 215,556€, kemi evidentuar se katër (4) pozicione nuk ishin realizuar, për të mundësuar rritjen e sasive në një pozicion tjetër prej 31,448€ apo rreth 14% të vlerës së kontratës. Çmimi për njësi i kontraktuar sasia e të cilit është rritur, ishte Gypa HDPE SN/8 Ø250 mm prej 16€ (pozicioni 5.1). Përderisa, në anën tjetër, çmimet e pozicioneve të cilat nuk janë realizuar ishin jo normalisht të ulëta dhe nuk ishin trajtuar si të tilla gjatë vlerësimit të tenderit. Përkatësisht, pozicioni 5.0 Gypa HDPE SN/8 Ø200 mm prej 1.01€, pozicioni 5.3 Gypa HDPE SN/8 Ø400 mm prej 4.99€, pozicioni 5.4 Gypa HDPE SN/8 Ø500 mm prej 8.2€ si dhe pozicioni 5.5 Gypa HDPE SN/8 Ø630 mm prej 9.1€.<br>• Te kontrata "Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas" prej 176,209€, përkundër se në këtë projekt ishte aplikuar një | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | aneks kontratë sipas rregullave të prokurimit në vlerë prej 17,201€, kemi evidentuar edhe ndryshime tjera në 43 pozicione prej 48,700€ apo 27% të vlerës së kontratës.<br><br>Sipas sqarimeve të zyrës së prokurimit, mos aplikimi i procedurave të prokurimit për këto ndryshime ishte për shkak të mungesës së njohurive lidhur me ndryshimet në rregullat e prokurimit publik. | | | | |
| 5<br><br>C1 | **Angazhimi i stafit përmes Marrëveshjeve për shërbime të veçanta për pozita të rregullta të punës** | Sipas Ligjit Nr. 06/L-0114 për zyrtarët, përkatësisht nenit 84, përcakton se "Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik". Përderisa neni 59 i RRUOPP ka përcaktuar qëllimin dhe procedurën e prokurimit publik lidhur Marrëveshjet për shërbime të veçanta. Përkatësisht, neni 59.1 ndër të tjera definon "shërbimet konsulente"– të cilat nënkuptojnë një shërbim të një natyre intelektuale apo konsultative, që furnizohet nga një konsulent ekspert dhe i kualifikuar në një fushë të caktuar apo profesion dhe | Kryetari duhet të sigurojë se për pozita të rregullta të punës angazhohet staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit dhe se procedurat e prokurimit për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta aplikohen vetëm për pozita specifike dhe të veçanta të cilat nuk mund të mbulohen nga stafi ibrendshëm i komunës. | Zyra e Prokurimit do të shqyrtojë në mënyrë të detajuar çdo kërkesë nga njësia kërkuese dhe aprovim nga ZKA për secilin konsulent i cili kërkohet që të shpallet me procedurë të Prokurimit dhe do të kemi parasysh gjetjen e auditorit. | Udhëheqësi i prokurimit | Në vazhdi-mësi |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përfshin shërbime ku aspektet intelektuale dhe kontributet mbizotërojnë dhe tejkalojnë aspektet tjera fizike të kontratës. Kemi evidentuar se komuna kishte angazhuar gjashtë (6) persona sipas marrëveshjeve për shërbimeve të veçanta përmes procedurave të prokurimit. Mirëpo, stafi i angazhuar ishin për punë dhe detyra të rregullta pune që duhet të kryhen nga stafi i rregullt i komunës. Vlera e kompensimit gjatë vitit 2022 për stafin e angazhuar në këtë formë ishte prej 10,226€. Sipas zyrtareve komunal kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së vendeve të lira për rekrutimin e stafit të rregullt (ku me rastin e krijimit të vendeve të lira, dy prej tyre ishin punësuar si staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit). | | | | |
| 6<br><br>C2 | **Mangësi në menaxhimi n e të dhënave nga tatimi në pronë** | Neni 11 paragrafi 1 i Ligjit me nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme - Zbritja për vendbanimin parësor, paraqet: "Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në Komunë apo | Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në sektorin e tatimit në pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin Protax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të | Do të identifikohen dhe do të përmirësohen të gjitha rastet së bashku me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamentin e Tatimit në Pronë- të cilët menaxhojnë me regjistrat e tatimit në pronë, e | Zyra e Tatimit në Pronë - Drenas | Korrigji-mi do të filloj në muajin korrik 2023 dhe do të jetë në |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000€) ngavlera e vlerësuar e njësisë së objektit".<br>Nga analiza e shënimeve në bazën e të dhënave të Protax-it kemi identifikuar 12 raste në të cilat zbritja prej 15,000€ për vendbanimin parësor ishte aplikuar dy herë te tatimpaguesit e njëjtë. Si rezultat, për arsye të nën-faturimit të hyrat janë më të vogla për 270€.<br><br>Sipas zyrtarëve komunal kjo gjendje për shkak të bashkimit të tatimpaguesve të cilit ishin të ndarë por të cilit nuk ishin pranuar në sisteminProtax për arsye të çështjeve teknike | komunës dhe me ligjin e tatimit në pronë. | specifikisht me sistemin Protax, sistemi është i ri si platformë, dhe nga bartja e të dhënave nga sistemi Protax i vjetër tek sistemi i ri Protax, kanë rrjedhur lëshime të ndryshme, si fshirje e verifikimeve, modifikimeve, azhurnimeve, fotove, si dhe janë bërë gabime në dyfishimin e lirimit nga banimi primar në më shumë se në një vend ashtu siç është paraparë me ligj.<br>Në kushte normale të punës, nuk ka mundësi që të caktohen dy banime primare, sepse nuk lejon sistemi, automatikisht tregon se tatimpaguesi e ka të caktuar një banim primar. | Për shkak të kompleksitetit të procedurave të modifikimit/ko-rrigjimit të sistemit Protax – ai menaxhohet nga Ministria e Financave Departamenti i Tatimit në Pronë | vazhdi-mësi |
| 7<br><br>B2 | **- Mangësi në menaxhi-min e pasurive** | Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare thotë se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Po ashtu, neni 19.4.3 i kësaj rregulloreje përcakton se duhet të bëhet | Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu, duhet siguruar se procesi i inventarizimit të | Do të marrim hapa që në afat sa më të shpejt të bëhet regjistrimi i pagesës së kontratës "Furnizimi i shkollave me kabinete për kimi, fizikë dhe biologji" në SIMFK sipas rekomandimit nga ZKA. | Zyrtar i Pasurisë | I menjë-hershëm |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare.<br>Kemi evidentuar se pagesat e kontratës "Furnizimi i shkollave me kabinetepër kimi, fizikë dhe biologji" prej 48,818€ janë regjistruar në sistemin E pasuria, përderisa kjo është dashur të bëhej në SIMFK sipas vlerës së furnizimeve për kabinete përkatëse.<br>Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëponuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.<br>Mangësitë në regjistrimin e pasurive si dhe procesin e inventarizimit, kryesisht ishin për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit të pasurive. | pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat. | | | |
| 8 | **Mungesa e projekteve ekzekutuese** | Neni 20 pika 10 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RrUOPP) kërkonqë "Specifikat teknike për | Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos | Do të hartohen projektet ekzekutive për të gjitha projektet kapitale të cilat | Të gjitha drejtoritë që kanë projekte kapitale. | I menjë-hershëm |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| B3 | | kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.<br>Nga 64 projekte kapitale në të cilat kishte shpenzim gjatë vitit 2022, kemi identifikuar se për 41 kontrata pune, Komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar proceduarat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë.<br>Shkaku i mungesës së projekteve ekzekutuese sipas zyrtarëve të komunësishte mungesa e buxhetit për kontraktimin e një operatori për hartimin e projekteve ekzekutive. | iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues, të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë. | kanë kosto të lartë financiare. | | |
| 9 | **Menaxhimi jo efektiv i llogarive të arkëtueshme** | Sipas nenit 16 të Rregullore MF-nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar,Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të | Kryetari, duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet e mundshme përfshirë edheato ligjore, | Në Sektorin e TPR, në Komunën e Drenasit gjatë këtij viti do të ndërmerren dhe do t'i kryejmë këto | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| B4 | | detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara.<br>Po ashtu, arkëtimi i të hyrave duhet të bëhet sipas afateve kohore tëpërcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.<br><br>Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Krahasuar me vitin paraprak rritja totale e të arkëtueshmeve ishte rreth 424,273€ apo rreth 12%. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë, përkatësisht në vlerë 1,843,543€ apo rreth 49%, taksës në biznese 1,361,734€ rreth 36%, qiratë 527,520€ rreth 14% si dhe lejet ndërtimore 19,573 rreth 1%.<br><br>Përkundër disa masave të ndërmarra, rritja e llogarive të arkëtueshme vit pas viti ishte për shkak të mos marrjes së të gjitha veprimeve të mundshme për arkëtimin e tyre. | për të siguruar efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. | masa, si: Vërejtjet, letërkujtesa, njoftime përfundimtare dhe në vitin 2023 do të fillojmë me procedura përmbarimore për obliguesit mbi 300,00 euro obligime, konform ligjit mbi tatimin në pronë. Kjo masë do të vazhdoj deri në inkasimin e të gjitha obligimeve të viteve paraprake. | Zyrtarët e tatimit në pronë | Në vazhdimësi |
| | | | | Sa i përket borxhit që lidhet me qiratë, Komuna do të ndërmarrë të gjitha masat me procedurat përmbarimore dhe lëndët që i kemi në procedurë Gjyqësore, do t'i kryejmë përmes Zyrës Ligjore të Komunës. Borxhi është pasojë e moskryerjes së obligimeve që dalin nga marrëveshja me MTI-në, të nënshkruar nga dy palët. | Zyrtari i të hyrave | Në vazhdimësi |
| | | | | Edhe gjatë vitit 2023 do të vazhdojmë me faturim, vërejtje dhe përmbarim për inkasimin e llogarive të arkëtueshme nga qiratë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nga taksat në Biznes do të marrim masa, ku gjatë muajve në vijim do të vazhdojmë me vërejtje dhe përmbarim për inkasimin e llogarive të arkëtueshme nga bizneset. | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Zyra Ligjore | Në vazhdi-mësi |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**ZYRA E KRYETARIT**

**Nr.** 01-052/01-32590

**Dt.** 07/07/2023

**RAPORTI FINANCIAR JANAR - QERSHOR 2023**

**KORRIK 2023**

## 1. Hyrje

Raporti financiar buxhetor, për periudhën janar – qershor 2023, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
Raporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës, mbulon periudhën janar – qershor të vitit fiskal dhe paraqet informatën e përcaktuar, që ka të bëjë me arkëtimin, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet dhe detyrimet.
Në tabelen e mëposhtme paraqitet buxheti fillestar i Komunës për vitin 2023,sipas kategorive ekonomike të shpenzimit.

*Tabela Nr.1 Buxheti Komunal sipas Ligjit Nr.08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.*

| Përshkrimi | Buxheti | Pagat | Mall e sherb | Komunalit | Subvenc | Kapitalet | Nr.punt |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Z.Kryetarit | 219,225.00 | 157,740.00 | 53,485.00 | - | 8,000.00 | - | 19 |
| Adm.person | 429,481.00 | 236,037.00 | 149,444.00 | - | - | 44,000.00 | 42 |
| Inspektorati | 121,231.00 | 68,581.00 | 52,650.00 | - | - | - | 10 |
| Z.Kuvendit | 154,330.00 | 109,927.00 | 44,150.00 | - | - | - | |
| Buxhet dhe finan. | 121,190.00 | 103,889.00 | 18,000.00 | - | - | - | 16 |
| Shërb Pub. Em. | 899,895.00 | 164,126.00 | 292,269.00 | 165,500.00 | 90,000.00 | 188,000.00 | 25 |
| Infrastruk Publike | 4,365,653.00 | 49,758.00 | 26,800.00 | - | - | 4,289,095.00 | 8 |
| Z.K.Kthim | 8,676.00 | 7,996.00 | 680.00 | - | - | - | 1 |
| Bujqësia | 148,521.00 | 76,192.00 | 12,329.00 | - | 60,000.00 | - | 13 |
| Planif.Zhvill.Ekon. | 107,235.00 | 48,985.00 | 26,250.00 | - | 32,000.00 | - | 8 |
| Gjeodezi dhe Kad. | 94,300.00 | 84,150.00 | 10,150.00 | - | - | - | 13 |
| Urbanizmi | 115,554.00 | 48,038.00 | 17,517.00 | - | - | 49,999.00 | 8 |
| Administrata Sh. | 113,902.00 | 36,562.00 | 52,340.00 | - | 25,000.00 | - | 5 |
| Kujd.Prim.Shënd | 2,637,796.00 | 1,476,351.00 | 587,445.00 | 54,000.00 | - | 520,000.00 | 181 |
| Shërb Sociale | 143,841.00 | 91,961.00 | 42,680.00 | 9,200.00 | - | - | 14 |
| Kultura dhe sporti | 867,470.00 | 75,295.00 | 122,175.00 | - | 125,000.00 | 545,000.00 | 13 |
| Adm. Arsim | 387,139.00 | 77,139.00 | 230,000.00 | - | 80,000.00 | - | 12 |
| Ars.Parafillor | 232,084.00 | 178,053.00 | 47,482.00 | 6,549.00 | - | - | 22 |
| Ars. Fillor | 5,522,309.00 | 4,628,133.00 | 424,176.00 | 65,000.00 | - | - | 740 |
| Ars. I Mesem | 1,466,614.00 | 1,319,142.00 | 125,472.00 | 22,000.00 | - | - | 177 |
| Totali I Buxhetit | 18,156,891 | 9,038,054.00 | 2,335,494.00 | 322,249.00 | 420,000.00 | 6,041,094.00 | 1,368 |

### 1.1. Performanca e të hyrave

Grumbullimi i të hyrave buxhetore ka vazhduar gjatë këtij tremujori. Të hyrat tatimore dhe jotatimore direkte kanë shënuar një rritje prej: 21.13 %, që korrespondon me shumën prej: 286,890.15 € më shumë se plani gjashtëmujor. Kjo rritje është e ndikuar nga procedurat përmbarimore për tatimin në pronë, qira si dhe taksa në firma. Pra të hyrat direkte të komunës për periudhën raportuese kanë arrit shumën prej: 965,624.15 apo 71.13 % të planit vjetor. Ndërsa Granti i performancës me shumë prej: 1,519,330.98€ ,Gjobat e Komunikacionit në shumë prej: 182,279.00€ si dhe gjobat e gjykatave në shumë prej: 18.817.50 € e për sqarim gjobat e gjykatav dhe komunikacionit të tremujorit të parë akoma nuk na janë alokuar për tre mujorin e dytë e që pritet të na alokohen(ndahen) në ditët në vazhdim.

### 1.2. Performanca e shpenzimeve

***Shpenzimet buxhetore*** për këtë periudhë kanë arritur shumën prej: 7,875,474.94 € përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, apo 40.00% të buxhetit të komunës për vitin 2023. Ky shpenzim kryesisht është i ndikuar nga ekzekutimi më i lartë i shpenzimeve nga kategoria e pagave dhe mëditjeve, kjo ka ardh si shkak i pagesave të shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit për sektorin e Arsimit dhe Shëndetësisë. Ndërsa ne kategoritë tjera kemi një nënshpenzim.

***Shpenzimet për paga dhe mëditje:*** gjatë këtij tremujori shënuan vlerën prej 5,308,358.79 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 58.67 % , krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori .Rritja ka ardh si shkas i pagesave të shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit për dy Sektorët (Arsim dhe Shendetësi) si dhe aplikimit të Ligjit Nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik. Fatura e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqet një rritje prej 8.67 % apo rreth 784,475.14 € më shumë se plani vjetor. Ndërsa krahasuar me vitin 2022 kemi ulje prej:1.85 % apo shuma prej: 167,127.68 €.

***Shpenzimet në mallra dhe shërbime:*** Gjatë këtij tremujori vlera e këtyre shpenzimeve ka arrit shumën prej:745,884.71 € dhe kemi një rënje prej 18.06 % krahasuar me buxhetin e ndarë për këtë vit. Ndersa krahasuar me vitin 2022, kemi një rritje prej: 40.89% apo shumën prej: 216,481.34 €.

***Shpenzime në komunali:*** shpenzimet për këtë kategori kanë shënuar rënie dhe kanë arrit shumën prej: 108,225.78, ndërsa krahasuar me vitin 2022 kemi një rënie prej: 27,170.62 € apo 8.04 %. Kjo rënie është sepse faturat e muajit qershor nuk janë bërë shpenzim,dhe pritet ditëve të ardhshme të ekzekutohen.

***Shpenzimet për subvencione dhe transfere:*** shënuan vlerën prej 92,074.50 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 21.92% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar të kësaj kategorie. Subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqitet një rënie prej 28.08 %, ndërsa krahasuar me subvencionet dhe transferet në periudhën e njejtë të vitit 2022, kemi rritje prej:12,950.70 €.

***Shpenzimet kapitale:*** janë realizuar me një normë jo të kënaqshme. Ato arritën vlerën prej: 1,620,931.16 €, që është 21.80 % e buxhetit vjetor të vitit 2023.Krahasuar me shpenzimet në këtë kategori gjatë periudhës së njejtë të vitit 2022 kemi rritje të shumës së shpenzuar për 965,291.22 €. Por edhe të kjo kategori e shpenzimeve kemi vonesa në realizim të punëve për shkak të situatës së krijuar me inflacionin I cili po ndikon në çdo lëmi ekonomike si dhe për shkak të rritjes së shumës së investimeve kapitale nga grantet e performancës në vlerë prej: 1,519,340.98 € dhe shumës së gjobave të gjykatave dhe komunikacionit në vlerë prej 201,196.50 €.

Sa i përket buxhetimit gjinor mund të themi se përqindja e femrave në listen e të punësuarve arrin në 45.69 % dhe buxheti i pagave i shpenzuar për këtë kategori ka shkuar në këtë perqindje të shpenzimit. **Gjithashtu komuna ka ndarë dhe subvencione për organizata jo qeveritare dhe individ dhe vetëm në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural janë ndarë subvencione në shumën prej 49,815.00 €. Poashtu edhe nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është ndarë shuma prej 2,600.00 €.**

Gjithashtu implikime buxhetore komuna ka pasur edhe pë shkak të aplikimit të dy kontratave kolektive për të cilat pagesat janë ekzekutuar nga thesari për shpenzime ushqimi dhe udhtimi, paga jubilare dhe paga percjellëse dhe vlera për keto pagesa të ekzekutuara nga thesari kap shumën prej: 393,778.25 €.

## Të hyrat vetanake për tremujorin e dytë të vitit 2023 dhe krahasimi me vitet paraprake

| Përshkrimi | 2021 | 2022 | 2023 | % me 2022 |
|---|---|---|---|---|
| | në Euro | | | |
| **1. GJITHSEJ TË HYRA** | **735,713.40** | **1,094,803.35** | **2,686,061.63** | **245.35** |
| **1.1. Të hyrat nga kodi 16301** | **46,741.16** | **61,738.57** | **65,937.50** | **106.80** |
| Taksa për certifikata (50013-50016) | 12,729.10 | 17,014.50 | 25,454.50 | 149.60 |
| Vërt.Fotok.dokumentacionit (50018) | 320.50 | 281.00 | 177.50 | 63.17 |
| Kërkesat 50019 | 4,472.00 | 3,819.28 | 3,201.50 | 83.82 |
| Të tjera 50413 | - | - | - | |
| Qeraja për Objektet Komunale 50408 | 29,219.56 | 40,623.79 | 37,104.00 | 91.34 |
| **1.2.Të hyrat nga kodi 16601** | **1,706.08** | **1,370.00** | **10,281.00** | **750.44** |
| Të hyra nga Inspeksioni | 1,706.08 | 1,370.00 | 10,281.00 | 750.44 |
| **1.3.Të hyrat nga kodi 17501** | **423,974.65** | **356,147.00** | **600,719.65** | **168.67** |
| Tatimi në pronë 40110 | 375,953.65 | 302,636.00 | 544,049.65 | 179.77 |
| Taksë për regjistrimin e automjetit 50001 | 48,021.00 | 53,511.00 | 56,670.00 | 105.90 |
| **1.4. Të hyrat nga kodi 18001** | **1,400.00** | **2,365.00** | **14,628.00** | **618.52** |
| Taksë për parki.nga Sh.Publike 50008 | 1,400.00 | 2,365.00 | 9,112.00 | 385.29 |
| Taksë për treg të hapur-kafshëve 50405 | - | - | 5,516.00 | |
| **1.5.Të hyrat nga kodi 18161** | **18,559.12** | **2,875.00** | | **-** |
| Taksë për leje ndërtimi 50009 | 2,875.00 | 1,435.00 | - | - |
| **Te hyrat nga kodi 47001** | - | 4.36 | | |
| Taksë nga Pylltaria 50107 | - | 4.36 | - | |
| **1.6.Te hyrat na kodi 48001** | **3,390.00** | **2,420.00** | **103,815.80** | **4,289.91** |
| Taksa në firma 50201 | 3,390.00 | 2,420.00 | 103,815.80 | 4,289.91 |
| **1.7.Të hyrat nga kodi 65005** | **23,219.50** | **26,746.50** | **43,243.50** | **161.68** |
| Taksë për regjistrim prone 50011 | 15,737.00 | 18,011.00 | 33,825.00 | 187.80 |
| Taksë për fletposeduese kopje planit. 50032 | 7,433.50 | 8,735.50 | 9,418.50 | 107.82 |
| Matje gjeodezike 50504 | 49.00 | - | - | - |
| | | | | |
| **1.8.Të hyrat nga kodi 66310** | **33,311.19** | **50,693.26** | **91,331.70** | **180.16537** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Taksë per leje ndërtimi 50009 | 29,358.16 | 40,409.59 | 80,579.01 | 199.41 |
| Shfrytëzimi i pronës komunale 50405 | 3,953.03 | 2,004.32 | 740.87 | 36.96 |
| Taksë për ndërrim të destinimit të tokës 50012 | - | 8,279.35 | 5,250.00 | 63.41 |
| Taksë për legalizim 50026 | - | - | 4,761.82 | - |
| **1.9.Të hyrat nga kodi 73100** | **14,126.00** | **16,286.00** | **17,637.50** | **108.30** |
| Participimi-shëndetësi | 14,126.00 | 16,286.00 | 17,637.50 | 108.30 |
| **2.0. Te hyrat nga kodi 85001** | **360.00** | **30.00** | **25.00** | **83.33** |
| Të hyrat nga qiraja e objekteve | 360.00 | 30.00 | 25.00 | 83.33 |
| **2.1. Te hyrat nga kodi 92210** | **15,835.50** | **16,542.70** | **18,004.50** | **108.84** |
| Participimi-Arsim | 15,835.50 | 16,542.70 | 18,004.50 | 108.84 |
| **2.1 Të Hyrat Indirekte** | **784,525.40** | **707,281.46** | **1,720,437.48** | **243.25** |
| Gjobat e gjykatave | 11,420.00 | 13,110.00 | 18,817.50 | 143.54 |
| Gjobat e komunikacionit | 246,035.80 | 189,313.50 | 182,279.00 | 96.28 |
| 1.7.3 Donacion | 527,069.60 | 504,857.96 | 1,519,340.98 | 300.94 |

**Shpenzimet për periudhën janar–qershor 2023 dhe krahasimi me vitet paraprake**

| **Përshkrimi** | **2021** | **2022** | **2023** | **Buxheti për vitin 2023** | **% e shpenzimit 2023** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Vitet** | **1** | **2** | **3** | **4** | **Me vitin 2022** |
| **2. GJITHSEJ SHPENZIMI** | **5,847,492.70** | **6,807,817.68** | **7,875,474.94** | **18,156,892.00** | **115.68** |
| **Shpenzimet operative** | **5,128,746.19** | **6,073,053.94** | **6,162,469.28** | **11,695,797.00** | **101.47** |
| 2.1.1 Paga dhe mëditje | 4,422,495.22 | 5,408,254.17 | 5,308,358.79 | 9,038,054.00 | 98.15 |
| 2.1.2. Mallra dhe shërbime | 625,147.41 | 529,403.37 | 745,884.71 | 2,335,494.00 | 140.89 |
| 2.1.3 Shpenzime komunale | 81,103.56 | 135,396.40 | 108,225.78 | 322,249.00 | 79.93 |
| | | | | | - |
| **2.2 Subvencione dhe transfere** | **121,058.83** | **79,123.80** | **92,074.50** | **420,000.00** | **116.37** |
| **2.3 Shpenzime kapitale** | **597,687.68** | **655,639.94** | **1,620,931.16** | **5,914,095.00** | **247.23** |
| **2.3.1 Rezervat** | **-** | **-** | **-** | **127,000.00** | **-** |

## Subvencionet për tremujorin e dytë dhe krahasimi me vitet parapake

| Përshkrimi | 2021 | 2022 | 2023 | % me 2022 |
|---|---|---|---|---|
| | Shumat në Euro | | | |
| Zyra e kryetarit | 2,200.00 | - | 1,200.00 | - |
| D.Shërbimeve Publike dhe Emergjenca | 78,978.29 | 27,674.00 | 27,279.50 | 98.57 |
| D.Bujqësisë | 1,466.83 | 28,000.00 | 49,815.00 | 177.91 |
| D.Zhvillimit ekonomik | 5,918.83 | 20,000.00 | - | - |
| D.Kulturë, Rini dhe Sport | 1,000.00 | 500.00 | 3,800.00 | 760.00 |
| D.Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale | 6,500.00 | 2,600.00 | 8,480.00 | 326.15 |
| D.Komunale e Arsimit | 24,954.88 | 349.90 | 1,500.00 | 428.69 |
| **Gjithsej** | **121,018.83** | **79,123.90** | **92,074.50** | **116.37** |

## Shpenzimet në projekte kapitale për periudhën janar–qershor 2023

| Kodi i projektit | Përshkrimi | Buxheti | Shpenzimet TM1+2/2023 | Mbetja | Progresi në % |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 5=2-3 | 6=3/2 |
| 18001 | **DSHPE** | | | | |
| 53316 | Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve vendban. | 40,000.00 | - | 40,000.00 | - |
| 53330 | Rreg.dhe rrethimi I varrezave Drenas dhe Komoran | 50,000.00 | - | 50,000.00 | - |
| 53341 | Zgjerimi i kamerave Drenas dhe Komoran | 5,000.00 | - | 5,000.00 | - |
| 53346 | Rregullimi I trotuarve dhe parkingjeve Drenas dhe Komoran | 5,000.00 | - | 5,000.00 | - |
| 53356 | Rregullimi I tregjeve Drenas dhe Komoran | 5,000.00 | - | 5,000.00 | - |
| 53364 | Rregullimi dhe zgjerimi i vendndaljeve dhe mbulimi i tyre | 10,000.00 | - | 10,000.00 | - |
| 50515 | Rregullimi i sistemit të ujitjes për parkun e qytetit me gyp | 50,000.00 | - | 50,000.00 | - |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 53313 | Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbruese | 23,000.00 | - | 23,000.00 | - |
| | GJITHSEJ | 188,000.00 | - | 188,000.00 | - |

| Kodi i projektit | Përshkrimi | Buxheti | Shpenzimet TM1+2/2023 | Mbetja | Progresi në % |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 5=2-3 | 6=3/2 |
| 18161 | Drejtoria e Infrastruktures Publike | | | | |
| 48254 | Rregullimi I shtratit të lumit Drenica dhe Verbica | 30,000.00 | 30,000.00 | - | 100.00 |
| 48632 | Asfaltimi I rrugës Gllanasellë, Godanc | 70,000.00 | 20,000.00 | 50,000.00 | 28.57 |
| 48635 | Asfaltimi I rrugës Paklek I Vjetër, I Ri, Vasilevë | 70,000.00 | 21,258.00 | 48,742.00 | 30.37 |
| 48638 | Asfaltimi I rrugës Dobroshec, Çikatovë e Vjetër | 70,000.00 | 20,360.00 | 49,640.00 | 29.09 |
| 48643 | Asfaltimi i rrugës në fshatrat Gradicë dhe Likoshan | 70,000.00 | 26,834.01 | 43,165.99 | 38.33 |
| 48646 | Asfaltimi i rrugës Arllat, Negroc, Gjergjicë dhe Bytyq | 70,000.00 | 70,000.00 | - | 100.00 |
| 48648 | Asfaltimi I rrugës Sankoc Fushticë | 70,000.00 | 28,674.10 | 41,325.90 | 40.96 |
| 48653 | Asfaltimi I rrugës Shtuticë, Verboc, Polluzhë | 70,000.00 | - | 70,000.00 | - |
| 48656 | Asfaltimi I rrugës Llapushnik, Poterk, Vukoc | 70,000.00 | 20,000.00 | 50,000.00 | 28.57 |
| 48658 | Asfaltimi I rrugës Z.ulët,Z. I Lartë, K. e Ulët dhe e Lartë | 70,000.00 | 70,000.00 | - | 100.00 |
| 48661 | Ndërtimi I kapaciteteve të ujësjellësit Drenas | 270,000.00 | - | 270,000.00 | - |
| 48682 | Bashkëfinancim projektesh me donator të jashtëm | 55,000.00 | - | 55,000.00 | - |
| 48693 | Kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferike Drenasi I,II,III,IV | 10,000.00 | 1,107.00 | 8,893.00 | 11.07 |
| 48694 | Kanalizimi I ujërave të zeza Komorani I,II,III,IV | 10,000.00 | 1,000.00 | 9,000.00 | 10.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 48705 | Kanalizimi I ujërave të zeza Sankoc Fushticë e Epërme dhe e Ultë | 10,000.00 | 10,000.00 | - | 100.00 |
| 48707 | Kanalizimi I ujërave të zeza K.e Ulët, e Epërme dhe Paldek | 10,000.00 | 1,000.00 | 9,000.00 | 10.00 |
| 48708 | Kanalizimi I ujërave të zeza Dobroshec, Çikatovë e Vjetër | 10,000.00 | 2,401.14 | 7,598.86 | 24.01 |
| 48709 | Kanalizimi I ujërave të zeza Abri e Epërme, Tërdec | 10,000.00 | 999.40 | 9,000.60 | 9.99 |
| 48710 | Kanalizimi I ujërave të zeza Gllanasellë, Godanc | 10,000.00 | - | 10,000.00 | - |
| 48711 | Kanalizimi I ujërave të zeza Gradicë, Likoshan | 10,000.00 | 999.14 | 9,000.86 | 9.99 |
| 48712 | Kanalizimi I ujërave të zeza Llapushnik, Poterk, Vukovc | 10,000.00 | 999.40 | 9,000.60 | 9.99 |
| 48713 | Kanalizimi I ujërave të zeza Nekoc, Kishnarekë | 10,000.00 | 10,000.00 | - | 100.00 |
| 49297 | Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi e Xhevë Lladrovci Dr. | 505,446.00 | 150,000.00 | 355,446.00 | 29.68 |
| 49298 | Kanalizimi I ujërave të zeza Krajkovë, Baicë, Damanek, Shtrubullovë | 10,000.00 | 999.50 | 9,000.50 | 10.00 |
| 49299 | Asfaltimi I rrugës Llapushnik Berishë | 70,000.00 | - | 70,000.00 | - |
| 51322 | Kanalizimi i ujërave të zeza Tersteniku I,II dhe Gllobar | 10,000.00 | 7,574.50 | 2,425.50 | 75.75 |
| 51323 | Kanalizimi I ujërave të zeza Shtuticë, Verboc, Polluzhë | 10,000.00 | 10,000.00 | - | 100.00 |
| 51324 | Asfaltimi I rrugëve Tërstenik I,II dhe Gllobar | 70,000.00 | - | 70,000.00 | - |
| 51326 | Kanalizimi I ujërave të zeza Arllat,Negroc, Gjergjicë dhe Bytyq | 10,000.00 | 8,794.50 | 1,205.50 | 87.95 |
| 51340 | Asfaltimi I rrugës Baicë, Krajkovë, Damanek, Shtrubullovë | 70,000.00 | - | 70,000.00 | - |
| 52309 | Ndërtimi I Rrugës Bregut te Qyqavices | 70,000.00 | - | 70,000.00 | - |
| 52310 | Ndërtimi I parkut dhe shtigjet për Këmbësor | 250,000.00 | 24,990.00 | 225,010.00 | 10.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 53631 | Ndërtimi I Kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza | 350,000.00 | 265,706.64 | 84,293.36 | 75.92 |
| 53635 | Rregullimi I trotuarëve dhe ndriqimit publik | 280,000.00 | 150,000.00 | 130,000.00 | 53.57 |
| 53645 | Asfaltimi I rrugëve dhe Kubzimi Drenas I,II,III,IV | 320,000.00 | - | 320,000.00 | - |
| 53652 | Asfaltimi I Rrugëve Komorani I,II,III,IV | 100,000.00 | 59,485.50 | 40,514.50 | 59.49 |
| 53659 | Ndertimi I tombinave dhe mureve mbrojtëse | 120,000.00 | 119,999.97 | 0.03 | 100.00 |
| 53660 | Ndertimi, zgjerimi dhe rekonstruimi I rrugëve të asfaltuara | 443,649.00 | 100,000.00 | 343,649.00 | 22.54 |
| 53666 | Ndertimi,zgjerimi i rrjetit të kanalizimit | 350,000.00 | 3,163.00 | 346,837.00 | 0.90 |
| 53670 | Asfaltimi I rrugëve Abri dhe Terdec | 70,000.00 | - | 70,000.00 | - |
| 53672 | Asfaltimi I rrugëve Nekoc, Kishnarekë | 70,000.00 | 29,999.99 | 40,000.01 | 42.86 |
| 53674 | Hapja e kanaleve kulluese gjatë rrugve Drenas Komoran | 25,000.00 | 22,701.01 | 2,298.99 | 90.80 |
| 92136 | Mbetja nga granti I performancës | 1,519,340.98 | 239,554.87 | 1,279,786.11 | 15.77 |
| | GJITHSEJ | 5,808,435.98 | 1,528,601.67 | 4,279,834.31 | 26.32 |

| Kodi i projektit | Përshkrimi | Buxheti | Shpenzimet TM1+2 /2023 | Mbetja | Progresi në % |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 5=2-3 | 6=3/2 |
| 47001 | Bujqësia | | | | |
| | Grant I donatorëve të brendshëm | 2,213.25 | - | 2,213.25 | - |
| | Gjithsejt | 2,213.25 | - | 2,213.25 | - |

| Kodi i projektit | Përshkrimi | Buxheti | Shpenzimet TM1+2 /2023 | Mbetja | Progresi në % |
|---|---|---|---|---|---|

| | 1 | 2 | 3 | 5=2-3 | 6=3/2 |
|---|---|---|---|---|---|
| 66310 | Urbanizmi | | | | |
| 53736 | Vendosja e sistemit te adresave | 5,000.00 | - | 5,000.00 | - |
| 53737 | Gjelbrimi I hapsirav Publike | 20,000.00 | 19,988.20 | 11.80 | 99.94 |
| | GJITHSEJ | 25,000.00 | 19,988.20 | 5,011.80 | 79.95 |

| Kodi i projektit | Përshkrimi | Buxheti | Shpenzimet TM 1+2 /2023 | Mbetja | Progresi në % |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 5=2-3 | 6=3/2 |
| 73100 | QKMF | | | | |
| 52311 | Zgjerimi I QMF- Arllat | 45,000.00 | - | 45,000.00 | - |
| 53709 | Rrethoja në QMF, AMF Komoran, Arllat, Nekoc, Terdec, Dobroshec | 20,000.00 | - | 20,000.00 | - |
| 53716 | Instalimi I nxemjeve nëpër QMF, AMF, Arllat, Gllanasellë, Nekoc, Tërdec | 70,000.00 | - | 70,000.00 | - |
| 53721 | Pjerrinat AMF, Arllat, Gllanasellë, Nekoc dhe Abri | 10,000.00 | - | 10,000.00 | - |
| 53722 | Paisje speciale mjeksore mbi 1000 € | 300,000.00 | - | 300,000.00 | - |
| 53726 | Vetura të ndihmes së shpejtë | 70,000.00 | 58,499.99 | 11,500.01 | 83.57 |
| | Gjithsej | 515,000.00 | 58,499.99 | 456,500.01 | 11.36 |

| Kodi i projektit | Përshkrimi | Buxheti | Shpenzimet TM1+2/2023 | Mbetja | Progresi në % |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 5=2-3 | 6=3/2 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 85001 | Drejtoria e Kulturës | | | | |
| 53732 | Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës, Muze, Arkiv, Bibliotekë, Teatër, Galeri | 300,000.00 | - | 300,000.00 | - |
| 53738 | Ndërtimi i Parkingut, Rrethojat, Fusha Sintetike në Drenas | 20,000.00 | 13,841.30 | 6,158.70 | 69.21 |
| 53739 | Fusha sportive dhe rekreacion, Dritan, Llapushnik dhe Terstenik | 115,000.00 | - | 115,000.00 | - |
| 89114 | Ndërtimi i Stadiumit Faza e Dytë | 100,000.00 | - | 100,000.00 | - |
| | Gjithsej | 535,000.00 | 13,841.30 | 521,158.70 | 2.59 |

| Kodi i projektit | Përshkrimi | Buxheti | Shpenzimet TM2/2023 | Mbetja | Progresi në % |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 5=2-3 | 6=3/2 |
| 93000 | Arsimi Fillor | | | | |
| 53684 | Dixhitalizimi I shkollave softwer, F,Lladrovci | 60,000.00 | - | 60,000.00 | - |
| 53686 | Paisje të Tik-ut R.Kiqina, F.Lladrovci, A.Bujupi, Xh.Gashi, A.Gashi | 60,000.00 | - | 60,000.00 | - |
| 53689 | Ndërtimi I Parkingjeve dhe Pllatove SH.Galica, G.Syla, 7 Marsi | 30,000.00 | - | 30,000.00 | - |
| 53691 | Ndërtimi I fushave të jashtme dhe rrethojave G.Elshani | 30,000.00 | - | 30,000.00 | - |
| 53696 | Këndi për lojëra dhe rekreacion Z.Hajdini, QEAP Ardhmeria, R.Kiqina | 40,000.00 | - | 40,000.00 | - |
| 53700 | Ndërtimi i rrethojave të shkollave, Nyjeve sanitare, ngjyrosja | 78,000.00 | - | 78,000.00 | - |
| 53706 | Instalimi i nxemjeve qendrore G.Syla, Z.Hajdini, | 14,000.00 | - | 14,000.00 | - |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 53687 | Kabineti në SHFMU D.Drenices, F.Lladrovci, D.Fortesës | 50,000.00 | - | 50,000.00 | - |
| | | **362,000.00** | **-** | **362,000.00** | **-** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **611** | **GJITHSEJ KOMUNA** | **7,435,649.30** | **1,620,931.16** | **5,814,718.14** | **21.80** |

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA GLLOGOC · REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY GLLOGOC · REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA GLOGOVAC

**Kryetari i Komunës**

**Ramiz Lladrovci**

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

**Komuna e Drenasit**

Zyra e Kryetarit

**01- Nr** 400/01 33377 **dt.** 11 07 **2023**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (" Gaz.Zyrt. e Republikës së Kosovës"), Dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049 si dhe në bazë të Zyrës së si dhe Zyrës Kombëtare të Auditorit, Prishtinë Qershor 2023, çështjen 4 - A 2, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën 27.07.2023 të aprovoj:

**PROPOZIM VENDIM**
**PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E RREGULLORËS PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA**

**NENI 1**

Me këtë Vendim, miratohet Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12 Nr.400-16587 të dt. 27.05.2020.

**NENI 2**

**Shtohet**; 13.6.Në munges të kodit për ngarkese bizneset do të tarifohet / ngarkohen në bazë të raportit të inspekcionit i cili konstaton veprimtarin të cilën e ushtron biznesi në teren:

- Gurthyes – 4,000.00 €;
- Pompa të karburantit në rrugë - Magjistrale - 2,000€ , Regjionale – 800 € dhe Lokale- 200€
- Trafo kryesore dhe shperndarës të energjisë elektrike - 3,000 €
- Institucione bankare – 2,500 € dhe Institucionet mikrofinacaire 1,500€
- Shërbime juridike – Avokatura-200€, Noter-500€, Përmbarues-700€ dhe Ndermjetesuaes-200€
- Ordinancat : Ordinancat shendetësore 380€, Ordiannca Stomatologjike 360€ si dhe Shërbimet tjera të njeriut 360€ ,
- Po ashtu caktimi i taksës për Kompanin NEWCO Ferronikeli i cili ngarkohet me dy kode te veprimtarisë si: minjer 25,000€ dhe prodhim i metaleve - shkritoret 65,000€.
- Si dhe veprimtarit tjera.

**Ndryshohet** pika ; 13.5.5 Drejtoria për zhvillim Ekonomik shpërndarjen e faturave do të bëjnë gjatë vitit fiskal dhe tarifat sipas këtij ndryshim-plotësimi do të vlejnë nga viti 2023.

**Shtohet:** 13.7 Subjektet ekonomike të cilat parashtrojnë kërkesë për pezullim të përkohshëm të procedurës së inkasimit pas prezantimit të deklarimeve 3 mujore nga ATK për mos ushtrim te veprimtarisë. Procedura e inkasimit për bizneset në fjalë pezullohet përkohësisht deri ne deklarimet vjetore.

**Shtohet -** 13.8. Shqyrtimin e ankesave kundër aktvendimeve të caktimit të taksës për ushtrimin e veprimtarive biznesore si dhe kërkesave të deklarimeve me zero do ta bëjë komisioni komunal i caktuar prej 3 anëtarëve ne mandat 3 vjeçar.

**Shfuqizohet** pika. 13.5.3. e rregullores me nr. Nr. 12 Nr.400-16587 të dt. 27.05.2020.

**NENI 3**

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Pas raportit te Zyrës Kombëtare të Auditorit, Prishtinë Qershor 2023 në çështjen 4 - A 2, respektivisht rekomandimin Nr.4 – A 2, kërkohet nga ana e kryetarit të komunës që të bëjë plotësim Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12 Nr.400-16587 të dt. 27.05.2020.

Me respket.